

### Neology and neologisms in the prose of Ismail Kadare.

**Abstract:** The creation of new words is a permanent source of expression in artistic literature. As new elements, they exert a special attraction and impact on the recipient-reader of the literary message. In artistic literature, neology and its product, neologisms, are a moment in the whole creative process. The great art of I. Kadare can not be conceived and analyzed without considering and focusing on the neology and neologisms that constitute a special aesthetic value of Kadare's creativity.

The following paper deals extensively with the contingency of new words in I. Kadare's prose, with their formation, meaning, usage and aesthetic function.

**Keywords:** neology, neologism, word formation, pre-, suffix, composition, aesthetic function

### Neologjizmat në tekstin letrar të I. Kadaresë, tipare të përgjithshme

Gjuhësia jonë e ka trajtuar në materiale të shumta çështjen e neologjizmave. Ka trajtime ku neologjizmat janë vështruar si teorikisht në aspektin gjuhësor, ashtu dhe në kuadrin e letërsisë artistike. Vlen të përmenden trajtimi teorik – gjuhësor i neologjizmave në tekstin “Leksikologjia e gjuhës shqipe” (Tiranë, 1999). Autori i tekstit, Jani Thomai, jep të dhëna për neologjinë dhe neologjizmat në gjuhën shqipe, për veçoritë e tyre ndërtimore e kuptimore. Dallohen si grup më vete neologjizmat stilistike, fjalëkrijime të shkrimtarëve në vepra të ndryshme letrare – artistike.

Po ky autor, në një artikull për neologjizmat e I. Kadaresë në librin “Koha e shkrimeve” e analizon grupin e fjalëve të reja si mjete me vlerë stilistike e me shprehësi të lartë. Mendime me vlerë për rolin e shkrimtarit në pasurimin e leksikut me fjalë të reja jepen dhe në studimin e Norbert Joklit “Naim be Frashëri e pasurimi i gjuhës shqipe”. Kështu, neologjizmat kanë tërhequr here pas here vëmendjen e studiuesve të gjuhës e të letërsisë. Si elemente të reja në gjuhë ato zënë një vend të veçantë dhe kryejnë shërbime me rëndësi. Disa prej tyre emërtojnë nocione të reja, disa të tjera emërtojnë nocione të njohura, por në mënyrë të re. Ka dhe neologjizma që emërtojnë nocione të rastit, konceptime psikologjike, subjektive.

Në letërsinë artistike krijimi i fjalëve është një moment që lidhet me mbarë procesin krijues. Ka krijime shumë të mira ku mund të mos gjeshe neologjizma. Prania e neologjizmave flet për një punë të ndërgjegjshme me gjuhën, për një kujdes të dukshëm që gjuha të jetë sa më terheqëse. Sa herë që bie fjala për leksikun e krijimeve të I.Kadarese është e pa mundur të lihet menjatë fjalëkrijimi, fjalët e reja të krijuara prej tij. Fjala e re, kjo mysafire e rrallë e veprave të para në prozë (“Gjenerali i ushtarisë sëvdekur”, “Kronikë në gurë”), bëhet e gjithgjendshme në veprat e pasme, si “Ura me tri harqe”, “Dimri i madh”, “Koha e shkrimeve” etj. Në punën me fjalën Kadareja shënon arritje që meritojnë të merren shembull e model. Ai kujdeset që të sjellë në ligjërim fjalë që e shprehin saktë e drejt mendimin. Saktësia kuptimore sjell forcë shprehëse. Fuqia shprehëse buron dhe nga ngjyrimet e ngarkesat kuptimore – emocionale që fiton fjala në ligjërim.

I. Kadareja shfrytëzon një numër të madh përfitesash, të përdorura ose të papërdorura nga të tjerë, për të ngarkuar e mbingarkuar fjalën që ajo të shprehë sa më shumë mendim dhe emocion e t'i përçojë këto sa më të plotë te lexuesi. Fjala me ngjyrimet e ngarkesa kuptimore-emocionale bëhet burim shprehësie.

Një burim i përhershëm shprehësie janë neologjizmat. Ato, kudo që shfaqen, bien në sy e bëjnë përshtypje. Neologjizmat nuk janë krijime, thjesht, për të bërë efekt, efekt gjuhësor. Por janë zëdhënëse të ideve të reja, ose janë një mënyrë e re shprehjeje. Prandaj ato marrin vlerë të veçantë në kuadrin e mbarë leksikut dhe bëhen “shprehje e prirjeve ideore e stilistike” të shkrimtarit.

Vështirë se gjen ndonjë fjalëkrijim në romanin “Gjenerali i ushtarisë sëvdekur”. Madje, ky roman, për vetë temën që trajton, ka një leksik disi të kufizuar në sasi. Nuk e ka ky roman gjerësinë leksikore të “Ura me tri harqe”. “Komisioni i festës”, “Muzgu i perëndive të stepës”, etj. Megjithatë është një krijim i bukur. Të krijohet ideja se bukuria e një rrëfimi nuk ka të bëjë aq me gjuhën e me leksikun e përdorur se sa me konceptimin e ngjarjeve e situatave. Sa më interesant e i veçantë të jetë konceptimi i botës, vizioni për të, aq më i bukur është krijimi; le të jetë gjuha e rrëfimit krejt e zakonshme. Por Kadareja jep dhe një model tjetër: krijime me një gjuhë të pasur, me leksik të gjerë në numër e në llojshmëri fjalësh.

Në ligjërim sillen fjalë të rralla, fjalë shumë të rralla, neologjizma befasuese etj. Krijimi i fjalëve të reja e përdorimi i tyre shpjegohet para së gjithash, me kujdesin e vazhdueshëm të shkrimtarit për shprehësinë e leksikut. (shih dhe: Jani Thomai: “Krijimtaria gjuhësore e shkrimtarit – shprehje e prirjeve të tij ideore e stilistike.” Drita, 25.1.1987). Pasi përdor shumë përfitesa për fuqizimin shprehës të fjalës, shkrimtari shfrytëzon dhe neologjinë, fjalëkrijimin, për ta pasuruar leksikun e veprës me njësi që shprehësinë e kanë një tipar tepër të dukshëm. Këto njësi i japin ligjërimin

një bukuri e një forcë të re, i shtojnë rrëfimit diçka krejt vatiake.

Në fushën e fjalëkrijimit Kadareja vepron si njohës dhe lëvrues i talentuar i gjuhës. Ai i krijon fjalët, në shumicën e rasteve, sipas modeleve të njohura e popullore. Fjalëkrijimet e Kadaresë janë kryesisht njësi njëfjalëshe. Ai krijon njësi njëfjalëshe për nocionet që shënohen në gjuhën e zakonshme me togje fjalësh. Psh.: Krijon njësinë frikshëm për shprehjen me frikë, darkëtar për i ftuar për darkë, enigmatizohet (bëhet enigmatik); legjendarizohet (bëhet legjendë); fundvjeshtë (fundi i vjeshtës) etj.

Një tipar tjetër i neologjisë te Kadareja është formimi i çerdheve të fjalëve. Në disa raste fjalët e krijuara formojnë një çerdhe, një familje semantike. Psh.: akullsi-akullsor; bosh (i)-boshësi; bashëndërr-bashëndërror; baltëron - baltisje - baltak; ftohton - ftohtësisht; hamendësohet-hamendësim; humneron - i humnershëm; krimbdëgjuese-krimbdëgjim - krimbëron; prangos - prangues; rënkueshëm - rënkimtar; i stërkeq - stërkeqet; shkëndijim - shkëndijues; i trishtëm - trishtueshëm; thashememnohet - thashethemnaje; vdekëron - vdeksor; vetmoj - vetmor; zymtor - zymtan - zymtësisht - zymtar; zhibëhet - zhibërje etj.

Duke u formuar nga e njëjta temë prodhuese fjalët e një çerdheje e ruajnë të përfocuar boshtin kuptimor që i lidh. Lidhjet në familjen semantike e mbajnë çdo fjalë në një kuptim të ngulitur, të palëvizshëm. Duke qenë pjesëtare të një familjeje neologjizmat humbin diçka nga pamja e tyre rastësore, duken si njësi që tashmë e kanë bërë vendin e tyre midis njërive të tjera, madje si njësi që kanë traditë përdorimi (gjë që nuk e kanë).

## Klasifikimi i neologjizmave

Në pikëpamje kuptimore fjalët e reja mund t'i grupojmë në këtë mënyrë:

### 1. Fjalë që kanë ekuivalente në gjuhë

Në këtë rast neologjizmi nuk shënon nocion të ri, por shërben si emërtim i ri i një nocioni jo të ri. Në planin onomasiologjik kemi dy variante emërtuese për të njëjtin referent. Midis dy fjalëve (neologjizmit e fjalës ekzistuese) ekuivalenca kuptimore mund të jetë e plotë. Shembuj:

plotshmëri- plotësi	(në Fjalor, 1980)
mjegullirë- mjegulli	( “ “ )
akullsirë- akullsi	( “ “ )
zhurmëri- zhurmërim	( “ “ )
shurdhëri- shurdhësi	( “ “ )
shurdhan- shurdhaman	( “ “ )
skeletik- skeletor	( “ “ )
i humbët- i humbur	( “ “ )
ftohton- ftoh	( “ “ )

drithëtirë - drithërimë ( “ ” )  
 mungonjës - mungestar ( “ ” )

Me gjithë ekuivalencën kuptimore me njësitë ekzistuese në gjuhë, neologjizmat e përmendura e bëjnë ligjërimin më të larmishëm. Në shumicën e rasteve ekuivalenca kuptimore midis njësisë së re dhe asaj ekzistuese nuk është e plotë. Midis tyre ka dallime të ndryshme, si:

a) Dallime në ngjyrimet kuptimore. Shembuj:

i hapësirshëm- i gjerë (në Fjalor, 1980)  
 hovzim- hov ( “ ” )  
 i përnxirë- i nxirë ( “ ” )  
 i shkretëtirtë- i shkrete ( “ ” )  
 dashurim- dashuri ( “ ” )

Në ballafaqimin e parë i hapësirshëm- i gjerë dy njësitë shënojnë realie e dallohen në përmasa. Fjala i hapësirshëm shënon përmasa më të mëdha se fjala i gjerë, ose permasat nuk janë të kapshme, janë të pakufishme. Në krahasimin e fjalës hovzim dhe hov dallimi ka të bëjë me formën e tyre të brendshme. Fjala hovzim motivohet, lidhet kuptimisht me foljen hovzoi (që nuk figuron në fjalor). Vetë folja motivohet me fjalën hov, e cila është e pamotivueshme (si fjalë e parme). Fjala hovzim shpreh rezultat të një gjendjeje, ndërsa hov shpreh një gjendje (kuptimi i dytë i fjalës hov në Fjalor: "Zhvillim shumë i shpejtë i dikujt a i diçkaje".

Në rastin e përnxirë-e nxirë fjala e parë shënon një cilësi, një ide më intensive.

Fjala i shkretëtirtë dallon kuptimisht nga fjala i shkretë nga një ngjyrim konkretësie që përmban. Këtë ngjyrim ia jep fjalës lidhja me njësinë shkretëtirë.

Edhe fjala dashurim shënon rezultat të një gjendjeje krahasuar me fjalën dashuri që shënon një gjendje. Kadareja e përdor fjalën e re në një kontekst të tillë: *Ana dukej sikure kishte vetë në dorë komandimin e **dashurimit** të saj* (Dimri, f.582).

Dallohen për ngjyrimet e tyre kuptimore, në krahasim me fjalët sinonime, formimet me parashtesën stër-. Këto formime shprehin ide të intensifikuara; i stërkeq (khs: i keq); i stërmoçëm (khs: i moçëm); i stërlavdishëm (khs: i lavdishëm); i stërmundimshëm (khs: i mundimshëm); i stërgjatë (khs: i gjatë); i stërlargët (khs: i largët); stërkeqet (khs: keqësohet) etj.

Megjithatë, neologjizmat e trajtuara mund të zëvendësoheshin me barasvlerat e përmendura, si njësi sinonime që janë. Duke sjellë në ligjërim ngjyrimet e tyre kuptimore të veçanta, neologjizmat e mësipërme i shtojnë informacionit dicka të re dhe e bëjnë atë më tërheqës.

b) Midis dy njësisve, barasvlera jo të plota, mund të ketë dallime në

ngjyrim efektiv. Njëra njësi përmban ngjyrimë emocionale-vlerësuese, tjetra jo, ose kanë ngjyrimë emocionale shkallësh të ndryshme:

mjeran- i mjerë	( në Fjalor, 1980)
zymtan- i zymtë	( “ “ )
shkurtan- i shkurtër	( “ “ )
qelqan- i qelqtë	( “ “ )
shurdhan- i shurdhër	( “ “ )
vrarak- vrapues	( “ “ )

Në çiftet e përmendura njësitë neologjizma kanë ngjyrimë afektive krahasuar me sinonimet përgjegjëse (të cilat mund të mos kenë te tilla), ose ngjyrimet emocionale të neologjizmave janë më të spikatura.

Për të patur një ide më të plotë për ngjyrimet afektive të njërive neologjizma po japim disa prej tyre në kontekstet ku janë vendosur: *Po na i bëj kabull o llambë e botës, ne të ngratëve, ne mjeranëve që s'na gjen shpirti rehat* (Koha, f.312). Fjala mjeranë flet për një mjerim të madh dhe për një vetëpërbuzje.

*Murmurima e errët zymtane e mijëra grave të zeshkëta të vendit të tij i afrohej kujtesës si një re e zezë* (Koha, f.135).

Fjala zymtane në krahasim me përgjegjësen e zymtë e jep tiparin në një shkallë më të lartë, gjë që shkakton emocione negative. Këto emocione e veshin fjalën dhe i transmetohen lexuesit.

*Te bërryli i tij i djathtë u përplas lehtë një shkurtan* (Dimri, f.142).

Me anë të fjalës shkurtan bëhet një lloj karikaturizimi i personit, njëkohësisht shprehet një lloj qëndrimi jo dashamirës i rrëfyesit.

*Ndërsa largohej, pati ndiesinë se sytë qelqanë të plakës i kishte akoma pas shpine* (Dimri, f.87).

Fjala mbiemërore qelqanë shënon një tipar të syve, shpreh njëkohësisht një ndjenjë antipatie për tiparin e për bartësin e tiparit (plakën Nurihan).

*Fytyra e tij kishte një brengë krejt shurdhamane* (Ura, f.417).

E përcaktuar nga njësia shurdhamane fjala brengë fiton ngjyrimë pesimiste më të forta. Përcaktori sinonim (brengë) e shurdhër nuk do ta jepte pesimizmin në përmasa të tilla.

*Ai kërkonte të çarën, zhapiun e vogël vrarak nëpër shkretëtirë* (Dimri, f.198). Fjala vrarak ka ngjyrimë diminutive krahasuar me sinonimin asnjës vrapues.<sup>1</sup>

1 Xhuvani - Çabej nuk i njohin prapashtesës-ak kuptime diminutive. Përdorimi i kësaj prapashtese në këtë kuptim përbën një shmangie nga rastet e zakonshme, është dukuri

c) Njësitë e barasvlefshme (neologjizmi dhe fjala përgjegjëse në gjuhë) dallohen nga ngjyrimi stilistik.

Ato mbajnë shenjën e stileve të ndryshme. Neologjizmat në veprën e I.Kadaresë, siç e kemi thënë, janë të llojit stilistik, janë krijime letrare artistike ose librore. Zakonisht, ato mbeten brenda veprës e nuk përhapen në ligjërimin e përditshëm. Pothuaj të gjitha neologjizmat e I. Kadaresë (me shumë pak përjashtime) kanë ngjyrim letrare artistike ose ngjyrim librore. Me ngjyrim të tilla ato i kundërvihen përgjegjëseve të tyre ndërstilore. Në grupin e neologjizmave dallohen për ngjyrim librore formime si : Mbiemra me prapashtesën – or: akullor (khs: i akullt); çmenduror (khs: i çmendur) ; inatçor (khs: i inatosur) ; mynxyror (khs: i mynxyrshëm), vetmor (khs: i vetëm).

Ndajfolje të formuara me prapashtesën – isht ose mbiemra me – shëm : butësisht, (khs: butë); ftohtësisht (khs: ftohtë) ; ngadalshëm (khs: ngadalë) ; rëndshëm (khs: rëndë) ; zbehtësisht (khs: zbehtë).<sup>2</sup>

I.Kadareja krijon një numër të madh mbiemrash e ndajfoliesh që dallohen nga fjalët përgjegjëse në gjuhë nga ngjyrimi stilistik. Por pjesa më e madhe e tyre veç dallimit në ngjyrimin stilistik paraqesin dhe dallime në kuptimet gramatikore. Fjala e re dhe fjala e njohur, sinonime me neologjizmin, u përkasin pjesëve të ndryshme të ligjëratës. Në raste të tilla neologjizmat mund të kenë barasvlerë kuptimore një grup fjalësh ose një fjalë të vetme që i përket një klase tjetër leksikoro-gramatikore. Këtë dukuri mund ta ilustronim me shumë shembuj : bezdisshëm (khs: me bezdi) ; beqarore (khs: dhomë beqari); dëshpërimisht (khs: me dëshpërim) ; floknore (kozmetikë e flokëve); hipokrizisht (me hipokrizi) ; katastrofikisht (në mënyrë katastrofale) ; kështjellon (ngre kështjellë); kujdesshëm (me kujdes) ; lodhshëm (në mënyrë të lodhshme) ; mbrëmësor (diell- i mbrëmjes); mundimshëm (me mundim) ; monotonisht (në mënyrë monotone); shqetësueshëm (me shqetësim) ; vajtueshëm (me vajtim); vëmendshëm (me vëmendje).

Siç është thënë më lart, Kadareja shpesh krijon njësi njëfjalëshe për disa nocione që shënohen në gjuhë me togje dy a më shumëfjalëshe. Nuk është fjala vetëm për ndajfolje e mbiemra, por dhe folje, emra. Fjala e krijuar nga shkrintari ka barasvlerë kuptimore në gjuhë një tog fjalësh ose një fjalë të vetme. Njësi të tilla njëfjalëshe ndihmojnë në paraqitjen sa më shkurt të informacionit. Rrallë herë u drejtohet ndërtimeve dy- a më shumë fjalëshe kur për to ka krijuar një fjalë të vetme. Përdorimi, ndonëse jo i dendur, i ndërtimeve dy a më shumëfjalëshe në vend të neologjizmave i mbron

---

vetiake e gjuhës së I. Kadaresë. (Shih: A.Xhuvani, E. Çabej, Studime gjuhësore, III: Prapashtesat e gjuhës shqipe. Studime gjuhësore, Prishtinë, 1976, f.138.

2 Formimeve të tilla mbiemërore dhe ndajfoljore u njihet ngjyrimi libror dhe në tekstin “Leksikologjia e gj.shqipe” (1984) të autorit Jani Thomai.

këto të fundit nga harxhimi semantik. Po japim një grup neologjizmesh të Kadaresë që kanë përgjegjëse shprehje të tëra gjuhësore: borëton – bie borë; baltëron – bëhet baltë (*... më tutje fusha e përmbytur baltëronte shkretueshëm*, Koha, f. 355). Baltisje – gjendje me baltë e një vendi (*... mes asaj baltisjeje të përgjithshme*, Ura, f. 32), baltak – me baltë (bregu baltak), Ura..f, 9); bërrylon.. bën bërryl (*fraza ...bërrylonte* befasisht anash (Dimri, f, 181) ; drekues – njeri që ha drekë (*Dy prej drekuesve vështruan në drejtim të bujtësit*, Gjakftohtësia, f.258); darkëtar - i ftuar për darkë (*Darkëtarët ishin ngritur tani nga tryezat*, Dimri, f.136); fillimtare - e fillimit (*do të punohej për fazën fillimtare të saj*, Ura, f.254); humnerohet - bëhet humnerë (*...Diçka i humnerohet brenda vetes*, Gjakftohtësia, f.238); humneron - bën humnerë (*e humneronte pa shpresë*; Koha, f.323); mesdimëror - i mesit të dimrit; mosbesues - që nuk beson (*mosbesues...ata ishin gati ti shpallnin luftë kujtdo*; Koha, f.298).

Përsëdyten- përsëriten së dyti; përsëtreten- përsëriten së treti (*Emrat përsëdyteshin e madje përsëtreteshin*, Emblema f.171).

Ndonjëra prej fjalëve të përmendura mund të përgjithësohet në përdorim, si përsëdytet, përsëtreten, bërrylon e ndonjë tjetër. Ngyrime librore kanë dhe disa formime emërore me prapashtesat im, si, -ri: boshëri(boshllëk); hovzim (hov); zhurmësi(zhurmë).

## 2. Një grup fjalësh të reja nuk kanë përgjegjëse në gjuhë

Kësisoj, ato shënojnë nocione të reja. Këto nocione i përkasin përfytyrimeve e vizionit të autorit për botën. Prania e nocioneve të tilla të reja e pasuron përmbajtjen ideo-emocionale të tekstit, ndërsa fjalët që i shënojnë nocionet pasurojnë gjuhën mjetin paraqitës të ideve e emocioneve. Ja disa shembuj:

*Përmes përthyerjes së lotëve vezullonte argjendërisht koka e një peshku* (Ura, f.267).

Nocioni argjendërisht, që jep idenë e një tipari veprimi, formohet duke u nisur nga nocioni për një tipar objekti: kokë e argjendtë. Me shoqërim idesh kalohet nga një nocion i njohur në një nocion të ri.

*Ose: Midis biojetës së tyre, asaj xhelatine amorfe...lëvizte herë pas here ndonjë kokë.* (Ura, f. 278).

Me fjalën biojetë shënohet nocioni që lidhet me jetën e viseve të truallzuara (siç i quan Kadareja), të shkombëtarizuara. Biojeta është një lloj vegetimi krijesash të çnjerëzuara.

Kuptimi i fjalëve që shënojnë nocione të reja është i motivueshëm, se nocionet e reja lindin si shoqërime nocionesh të njohura. Shembuj: *Ndërsa ecte, atij i përhiheshin flokët e njerëzve të familjes së Bermemajve,*

ajo **gështenjishte** e shpërndarë tejetbanë fisit (Dimri, f.285). Nocioni **gështenjishte** formohet mbi bazën e nocionit ngjyrëgështenjë. Tipari i shënuar me këtë fjalë rroket i abstraguar në rastin e fjalës **gështenjishte**. Nuk është fjala për një tipar konkret të secilit anëtar të fisit, por tipari abstragohet duke u shprehur me fjalën **gështenjishte**. Formimi **gështenjishte** përbën një shmangie nga modeli i njohur, i përgjithshëm kuptimor. Në gjuhën shqipe me prapashtesën -ishte (- **ishte** është variant i **-ishtë**) formohen emra që tregojnë vendin ku gjendet një shumicë sendesh nga ato që shënon fjala primitive ose ku gjendet me shumicë fjala primitive; psh.: **ahishtë, ranishtë** etj.<sup>3</sup>

Ndërsa, në rastin e fjalëformimit **gështenjishte**, që pritej të ishte pyll me **gështenja**, është një tipar abstrakt që ka të bëjë me ngjyrën e flokëve të mbarë një fisi.

Ose: *E pashë që larg, midis turmës së njerëzve, tek vinte me atë **hënëzim** të përhershëm mbi krye* (Ura, f.506). Fjala **hënëzim** përdoret për të shënuar pamjen dhe përshtypjen që bëjnë flokët e Lida Snjeginës, personazh në novelën “Muzgu i perëndivë të stepës”.

*Mirëpo **jetimëria** e urës...mori fund papritur ditën e 29 tetorit* (Ura, f.100). Nocioni **jetimëri** është formuar duke abstraguar një cilësi nga realitet që e kanë: Ura jetime-jetimëria e urës. Me anë të abstragimit të cilësisë kalohet në një nocion të ri abstrakt.

*Si gjithmonë gjithçka tek ai ishte **nofullore*** (Ura, f.470). Fjala **nofullore** më tepër se diçka konkrete shënon një imazh që lind nën përshtypjen e një tipari konkret e që bie në sy. Kjo fjalë përdoret në portretizimin e Druzinit, personazh i novelës “Muzgu i perëndivë të stepës”. Përdorimi i elementit **nofullore** e bën paraqitjen më mbresëlënëse. Në këtë mënyrë vihet më tepër në dukje një e metë në fytyrën e personazhit, nofullat masive.

Duke u paraqitur kjo e metë si një lloj simboli, si një lloj shenje përfaqësuese, shprehet, njëkohësisht dhe qëndrimi jo dashamirës ndaj personazhit.

Ose: *Ideja se, duke humbur postet mund të fitonte atë **qelqëri** rrëzëlluese e përshkoi ftohtësisht* (Dimri, f.277). Fjala **qelqëri** shënon një nocion abstrakt cilësie që buron nga nocioni **i qelqtë**.

Në disa tablo shkrimtari kalon në përshkrimin e gjendjeve të tejshme, në përmasa ireale e deri në përfytyrime surrealiste. Për të emërtuar disa nocione surrealiste përdoren neologjizma që krijojnë një përshtypje krejt të veçantë. Të tilla janë fjalët: **shkokë, çjetë, zhvend, mosdukje, mosgëzim, mospjellje, zhbëhet, zerokrejt, vdekëron, tejjetshmëri, shkokëzohet, stërvdekje, stërvdekje, stërshtet, stërqiel, supershtet, parakëngë, nulgjuhë, nulkujtësë, mosgjë, e mbijetshme, antiurë etj.**

3 Shih për këtë: Xhuvani-Çabej, Prapashtesat e gjuhës shqipe, Tirane, 1962.



Këto neologjizma përfshihen në këtë grup (2) me që shënojnë nocione jo të njohura, prodhime të mendimit e të fantazisë së autorit. Forca sugjestionuese e krijimeve të tilla është e veçantë. Lexuesi e pranon domethënien e tyre pa bërë pyetje, si: Ç'është antiura? Ç'është parakënga ose nulkujtesa?

### 3. Neologjizma kontekstuale (ose neologjizma efemere)

Ky grup neologjizmesh është i afërt nga kuptimi me grupin 2. Fjalët që përfshihen këtu nuk kanë përgjegjëse në gjuhë. Neologjizmat kontekstuale janë krijime të çastit, kanë vlerë brenda një konteksti ku e rrezatojnë tërë shprehësinë e tyre. Të rimarra në kontekste të tjera ato nuk e bëjnë përshtypjen e parë, paraqiten të fshira e të konsumuara.

Me anë të tyre përmbushen kërkesa të çastit, pas kësaj ato vdesin. Neologjizmat kontekstuale janë emërtime të dyta të realieve të ndryshme. Emërtimi bëhet mbi bazën e përjasjes së realieve, (si në rastin e formimit të metaforave). Njëri emërtim kalon në realien tjetër kur realiet konsiderohen të ngjashme/të krahasueshme. P.sh.: Në novelën “Krushqit janë të ngrirë” doktoresha Shkreli, në një rast emërtohet Antiledi – Makbeth, emërtimi bëhet në çast dhe është befasues. Shpjegimi i emërtimeve bëhet lehtë me anë të personazhit të Shekspirit, ledit Makbeth që ishte ashtu, e përgjakur, kur bëri vrasjen. Por dy përgjakjet kanë shkaqe të kundërta. Prandaj doktoresha emërtohet Antiledi-Makbeth. Emërtimi përbëhet nga tri fjalë të bashkuara në një. Vëllimi i madh fonetik e kuptimor bën që fjala të tërheqë vëmendjen. Grupi i neologjizmave kontekstuale nuk është i vogël. Në këtë grup ndërtime, si: Antiledi- Makbeth, ka disa. Në romanin “Kronikë në gurë”, Suzana, një personazh që tërheq vëmendjen me delikatesën, brishtësinë dhe psikologjinë e vajzës në prag të rinisë, emërtohet avio-lejlekoflutur. Është një emërtim intuitiv. Imazhi që paraqet fjala lidhet me përfytyrimin e trupit të brishtë të Suzanës (që krahasohet me lejlekun e fluturën) i kombinuar me përfytyrimin e avionëve të aeroportit. Në trurin e përgjumur të rrëfyesit përzihet imazhi i Suzanës dhe i avionëve, dy objekte me forcë zotëruese në shpirtin dhe në mendimin e tij; krijohet një imazh i vetëm, ireal, figurë ëndrrash. Për të shënuar nocionin që lind përdoret fjala avio- lejlekoflutur e cila i transmeton përfytyrimet dhe devijimet psikologjike të rrëfyesit. Për ta ilustruar këtë po japim tekstin ku gjendet fjala e re:

*Suzanë ! Ti asgjë nuk di për aeroportin. Atje te ju tani është shkretëtirë. Fryn erë ! Fryn, fryn, **avio- lejlekoflutur**. Ku fluturon kështu ? Në qiell ka avionë (Kronikë, f. 108).*

Në romanin “Dimri i madh” kemi një tjetër fjalëkrijim të këtij lloji: *Po si mund të vajtohet, nën një flamur të turpëruar ? Korbët ne, **flamurleshprerët**,*

*tha me vete me tmerr* (f. 121). Fjala flamurleshprerët lindi për të emërtuar një imazh ku përzihet përfytyrimi i një flamuri në të cilin shqiponja është pa krahë me përfytyrimin e grave që ju prisnin flokët kur bënin ndonjë turp (zakonish në krahinat veriore). Një imazh i tillë është llahtarisë, gjë të cilën e trasmeton dhe fjala. Karroca me të cilin udhëtoi Besian Vorpsi me të shoqen në novelën “Prilli i thyer” emërtohet karrocë -flutur-arkivol. Ky emërtim shënon, në fakt, përfytyrimin e Gjorgut për këtë mjet transporti. Ky objekt nuk është i zakonshëm për Gjorgun, por i jashtëzakonshëm e tronditës, me që atje pa, për herë të parë e të fundit, Dianën. Prandaj karroca i mbetet në mendje, e riemërton duke i shtuar emrit të saj emra objektesh të tjera me të cilat i duket e krahasueshme:

*Dhe brenda asaj karroce – flutur – arkivol ishte vështrimi i femrës me flokë të gëshetenjta që e kishte përpirë Gjorgun aq ëmbëlsisht dhe aq tronditshëm* (f.314).

Ky emërtim del vetëm një herë, vetëm një rast i jepet për të shfaqur emocionin që përmban. Duke e parë shprehësinë e njëjësive leksikore në përpjestim të zhdrejtë me dendurinë ë përdorimit, në formime të tilla shprehësia paraqitet në kufij maksimalë. Ndodh harxhim i menjëhershëm i shprehësisë. Rimarrja e tyre në çfarëdo lloj rrethane është pa efekt.

Këto lloj neologjizmash quhen edhe efemere <sup>4</sup> duke marrë parasysh jetën e tyre të shkurtër.

Me shoqërim idesh është krijuar dhe neologjizmi avion kalëbaladash. Ideja e baladës përqaset me idenë e kalit të legendës për besën e dhënë:

*Së shpejti, duke çarë mespërmes hapësirës dimërore me avion-kalë-baladash, në dyluftimin e tmerrshëm me perënditë shkurtabiqe të stepës, do të vinte Enver Hoxha* (Ura, f.316).

Ja dhe disa shembuj të tjerë që përmbajnë neologjizma të tilla:

*Gjithë dekori lugato-xhindëror i mesjetës nuk ishte vecse një maskë për të mbuluar të vërtetën* (Emblema, f.65), (Ura, 475).

*Së shpejti do të hynte prilli, Prillmort* (Gjakftohtësia, f.310).

*I rrezikshëm ishte në gjëndjen e tij të zakonshme solemnorozë-buzëqeshëse* (Ura, f.409).

Neologjizmat e sipërpërmendura janë ndërtime me kompozim.

Kompozimet përmbajnë sasi të ndryshme fjalësh, dy ose më shumë. Fjalët e bashkuara mund të lidhen kuptimisht (lugat-xhindëror, fjalët janë sinonime). Në shumicën e rasteve fjalët kanë kuptime të ndryshme. Kështu, secila fjalë sjell informacion të ri. Kjo bën që vëllimi kuptimor i njësisë së re

---

4 Kështu emërtohen neologjizma të tilla në “Stilistique française”, Moskë, 1970, f.146.

të përftuar të jetë i gjerë. Njësia e re bën përshtypje jo vetëm me vëllimin e gjerë kuptimor, por edhe me kontrastin kuptimor të fjalëve të bashkuara. Kuptimet e fjalëve në disa raste janë rrafshesh të ndryshme: një kuptim është abstrakt, tjetri konkret (**solemno-rozë-buzëqeshëse**); një kuptim përfaqëson realie të përgjithshme, tjetri realie të përveçme: (mjegullo-pasternakore); njëri kuptim është i drejtpërdrejt, tjetri i figurshëm (**karrocë-flutur-arkivol, avion-kalëbaladash**).

Neologjizmat kontekstuale të formuara me kompozim janë më të shumtat në numër; mund të përmendim këtu edhe fjalët: **kaltëroralpin, mjegullkaltëror, karrocë-lavire** etj.

Veç këtyre rasteve, ku emërtimi i ri formohet mbi bazën e shoqërimit të ideve dhe kuptimi i ri ka natyrë të figurshme (plotësisht ose pjesërisht), ka raste kur fjala e re paraqitet si kompozim fjalësh të njohura. Kuptimi i fjalës së re është një shumë e kuptimeve të fjalëve përbërëse. Nuk ka këtu mbartje emërtimi, por një bashkëlidhje fjalësh të cilat formojnë një njësi të re me kuptim të drejtpërdrejtë, p.sh.:

*Trashëgimtarët e qiramarrësve të shtëpive e çerekshtëpive... u dëshpëruan (Emblema, f.177).*

*Kishte qenë kundër dekretimit të **Ferexhefermanit** (Koha, f.129).*

*Ai, demon me shirit të zi në ballë, **grambulues** (Koha, f.151).*

*Ishte një **gjysmëroman** ose më keq s'ishte as gjysmë (Koha, f.36).*

*Qeshja...kishte rrjedhur përmes syve të tij atë **gjysmëorën** e fundit (Ura, f.154).*

*Dëgjoheshin krimbat që gërryenin drurin. Qetësi **krimbdëgjuese... Krimbdëgjim**. Më pëlqeu kjo fjalë (Kronikë, f.145).*

*Trëndafilat e bardhë që më kujtoheshin, perdet e dhomës së madhe, **këmishënata** e bardhë e gjyshes...(Kronikë, f.195).*

*Ushtrinë **rebelshtypëse**, do ta udhëhiqte pashai i rangut të tretë, Bugrahani (Ura, f.227).*

*Mblidheshin dëshmi të vjetra e të reja për të vërtetuar se **vakëflënësi** kishte qenë i sëmurë (Emblema, f.181).*

*Ata **vetëçheroizoheshin** dhe i humbnin cilësitë e tyre të mirëfillta (Gjakftohtësia, f. 234).*

Në klasën e neologjizmave efemere ka një grup fjalësh tepër të përkohshme, më jetëshkurtëra se ekzemplarët e tjerë të kësaj klase. Në raste të tilla kemi të bëjmë me një formim, kuptimi i të cilit mbështetet në një tipar tepër kalimtar të objektit që emërtohet. Tipari nuk ka të bëjë

me cilësi, por thjesht me vendndodhjen ose ndonjë rrethanë tjetër të përkohshme:

*Rrokut i shkoi ndërmend se ishin pikërisht zërat nervozë të **paradyqanësve** të tij që nuk e linin klientin të fliste (Dimri, f.242).*

*Të gjithë bij të "Abdullait" emri me të cilin shënoheshin në defter të **porsaislamizuarit** (Koha, f.88).*

*Zogjtë e rrallë fluturojnë ultas mbi to, mbi atë **asnatasditë** pikëllimtare që vazhdon gjashtë muaj (Ura, f.400).*

*Dita e re **disaorëshe** ishte akoma foshnjë e dobët (Dimri, f.389).*

Disa nga neologjizmat efmere janë formuar me ndajshitesim. Këto nuk e kanë gjerësinë kuptimore dhe shprehësinë e fjalëkrijimeve me kompozim. U mungon dhe aftësia evokuese. Ato janë të motivueshme dhe, gjithsesi, shprehëse si emërtime të reja e të papritura, p.sh.:

*Kishte aty gjithfarë meditimesh e faktesh për flokët e njerëzve nëpër shekuj... streset e shkaktuara nga rënia e flokëve, **qimemanët, qimefobët**... (Koha, f.236).*

*Madje ajo pjesë e reportazhit të tij, ku flitej se **qamilistët** digjinin kullat e çifligarëve,...që shkurtuar në redaksi (Koha, f.327).*

***Rrugorët** e kishin kuptuar që **ujorët** paguanin një njeri për të dëmtuar natën urën (Ura, f.85).*

*Shpinat e delegatëve largoheshin e largoheshin vazhdimisht...**Shpinëri**, tha me vete Besniku (Dimri, f.200).*

***Hënaku** që...e merrte rrogën vetëm për përgjimin e hënës, e dha kushtrimin me vonesë (Dimri, f.189).*

Në grupin e neologjizmave efmere përfshihen dhe disa formime psikologjike. Këto formime nuk ndjekin ndonjë model gjuhësor, por krijohen në bazë të konceptimit të botës nga rrëfyesi. Motivimi i njësisë është gjithashtu psikologjik; është një përftesë psikologjike që shndërrohet në strukturë gjuhësore:

*Kaloi e mërkura, e enjtja. Pastaj e **premteshtunediola** (Kronikë, f.160).*

## **Formimi i neologjizmave**

*Formimi i neologjizmave me parashtesim*

Neologjizmat e mbledhura në prozën e Ismail Kadaresë përbëjnë një listë jo të shkurtër, një fjalorth ku përfshihen fjalë klasash të ndryshme leksiko-gramatikore e tipash të ndryshëm fjalëformues. Fjalëkrijimet i

përkasin grupit të fjalëve leksikore, janë fjalë emërtuese: emra, mbiemra, folje, ndajfolje. Për të trajtuar mënyrën, tipat e mjetet formuese të neologjizmave do t'i shqyrtojmë ato të ndara në klasa leksiko-gramatikore. Klasa më e pasur është ajo emërore. Numërohen rreth 147 neologjizma emërore. Të gjitha neologjizmat janë fjalë të prejardhura. Si mënyra formimi përdoren ndajshitesimi, kompozimi, rrallë takohen formime pa ndajshitesa. Në mënyrën ndajshitesore më produktiv paraqitet tipi prapashtesor, formimet parashtesore janë më të pakta. Tipin parashtesor, me që nuk është ndonjë tip produktiv, po e vështrojmë për të gjitha kategoritë leksiko-gramatikore së bashku. Kjo dhe për arsyen tjetër se, në më të shumtën e rasteve, parashtesat nuk janë të specializuara për formime emrash apo mbiemrash, foljesh e ndajfoljesh, siç ndodh me prapashtesat. Parashtesat, përgjithësisht, nuk e ndërrojnë kategorinë leksiko-gramatikore të fjalës së cilës i paravihen gjatë fjalëkrijimit.

Për krijimin e fjalëve me parashtesim Kadareja përdor këto parashtesa: anti-: Me këtë parashtesë formohen fjalë, si: antiurë, antiskënderbejada, antishekspir, antibethoven.

Formimet kanë ngjyrimet librore, gjë që i detyrohet, kryesisht, parashtesës.<sup>5</sup>

Ngjyrimet emocionale-vlerësuese të këtyre krijimeve janë gjithashtu evidente. Formimet shprehin të kundërtën e asaj që shprehin fjalët pa parashtesë. Në romanin "Dimri i madh" me fjalët antishekspirë dhe antibethoven emërtohen militaristët sovjetikë që ngrenë flamurin e mbrojtësit të artit në një kohë që janë antihumanistë, si rrjedhim dhe antiart (në roman).

Parashtesa anti- në gjuhën shqipe nuk përdoret me emra të përveçëm (veç formimit Antikrisht). Prandaj fjalëkrijimet me parashtesën anti+emër i përveçëm përbëjnë një shmangie nga modeli i zakonshëm strukturor. Jo vetëm nga struktura, por edhe nga përmbajtja këto krijime leksikore i shmangen modelit (të përgjithshëm) semantik. Kur parashtesa anti- i shtohet një emri të përveçëm, fjala e krijuar shënon një rrymë; kështu Antikrisht ka kuptimin antikrishtërim. Fjalët e gjetura te Kadareja nuk kanë kuptim të tillë, s'kanë të bëjnë me rryma a ndjekës të rrymave.

Me fjalën antiurë në novelën "Ura me tri harqe" emërtohet një pseudourë pa funksion. Fjala, veç kuptimit nocionor, përmban dhe emocione pesimiste për një objekt që mund të ishte i dobishëm, por që është ngritur atje ku nuk është i nevojshëm, në mes të fushës.

Parashtesa ç-: Përdoret për të formuar folje dhe emra nga folje dhe emra të tjerë me kuptim të kundërt. Formimi i emrave në këtë mënyrë është një nga veçoritë e gjuhës së Ismail Kadaresë.

Në FGJSSH, 1984, f.147, parashtesës ç- i njihet aftësia për të formuar folje

5 Në FGJSSH, 1980, parashtesa anti- shoqërohet me shënimin libror (libr:).

e mbiemra nga folje e mbiemra të tjerë me kuptim të kundërt. Kadareja formon dhe emra me kuptim të kundërt nga emra të tjerë, duke mos ndjekur kështu asnjë model të njohur (në veprat normative) strukturor a semantik, p.sh. fjala çjetë formohet nga tema emërore jetë.

Ka dhe formime foljore, si çmishëron (nga mishëron).

Krahas parashtesës ç- gjatë fjalëkrijimit, përdoren edhe variantet e saj sh-, zh-. Me këto variante krijohen folje, si: shkakëzohet, zhbëhet, por dhe emra, si: shokë, zhvend.

Formimi shkokëzohet ka disa veçanti, ai përbën një shmangie si në pikëpamje formale dhe në pikëpamje semantike. Parashtesa sh- i paravijet një teme (kokëzohet) që nuk ka ekzistencë reale në gjuhë. Vetë fjala shkokëzohet shpreh një gjendje imagjinare, ireale. Arrihet në formimin e një fjale me kuptim ireal duke përdorur një model të njohur formal, një morfemë të njohur (sh-) dhe një morfemë të paqenë (- kokëzoh).

Rregullisht, morfemat që kombinohen në formimin e fjalëve të reja janë të pranishme në sistemin gjuhësor. Ato janë të njohura, jo të reja, ndërsa njësia që del nga bashkimi i tyre është e re.

Kjo gjë nuk ndodh në krijimin e fjalës së sipërmendur. Ndërsa në krijimin e zhvend kemi bashkimin e zh- + vend; morfema zh në gjuhën tonë, gjatë fjalëformimit, nuk bashkohet me tema emërore. Kjo shmangie formale shoqërohet me një shmangie nga modeli semantik (i përshkruar dhe rekomanduar nga veprat drejtshkrimore e normative të gjuhës sonë).

Rezulton një fjalë me kuptim ireal, imagjinar, gjë që nuk ndodh në fjalëformimin e zakonshëm gjuhësor. Parashtesa mos- : përdoret për të formuar emra e përemra me kuptim mohues ose të kundërt me atë që shprehet nga tema fjalëformuese.<sup>6</sup>

Shembuj: Moskuptimin, mosbesues, mosdashuri, mospërgjigje, mosgëzim, mosgjë, etj.

Fjalët e përmendura formohen sipas rregullash të njohura, ndjekin gjedhe formale e kuptimore të njohura. Xhuvani dhe Çabej kanë vënë në dukje karakterin dituror të formimeve me mos-. Për këto formime ata thonë se janë neologjizma të sajura në këta brezat e fundit.<sup>7</sup> Edhe te Ismail Kadareja ato paraqiten si krijime diturore dhe bijen në sy së tepërmi meqë janë më të reja se formimet e tjera të njohura me parashtesën mos- : mospagim, mospranim, mospërfillje etj. Këto kanë zënë vend në mbarë sistemin/leksikonin e gjuhës. Me parashtesën pro- formohen emra, si: protrojan, me kuptimin "përkrahës i trojeve". Fjala e formuar merr ngjyrimë librorë të parashtesës.<sup>8</sup> Përdoret gjithashtu dhe parashtesa

6 Një funksion i tillë u njihet këtyre parashtesave në FGJSSH,1980, si dhe në punimin "Parashtesat e gjuhës shqipe" të autorëve Xhuvani dhe Çabej.

7 Në FGJSSH, 1980, pro - si parashtesë, është e markuar, mban shënimin libror.

8 Shih më gjërësisht : A. Xhuvani, E. Çabej: Parashtesat e gjuhës shqipe, BSHSH, 1956, 4,

super- në formime si, supershtet. Formime të tilla kanë ngjyrimë librorë, gjë që i detyrohet vetë parashtesës.<sup>9</sup>

Parashtesa stër – paraqitet disi produktive meqë merr pjesë në formimin e shumë fjalëve. Fjalët e formuara me të tregojnë diçka që ka madhësi dhe përmasa të jashtëzakonshme ose ireale. Formime të tilla, që shënojnë diçka me përmasa të pakakapshme, ireale, janë krijime leksikore krejt origjinale të I. Kadaresë: stërqiell, stërvedje, stërlërimë, stërshtet.

Me parashtesën stër – janë formuar emra e mbiemra: i stërkeq, i stërmoçëm, stërbret, i stërlavdishëm, i stërmundimshëm, i stërgjatë ; formohen dhe folje: stërkeqet. Siç vënë re Xhuvani – Çabej, parashtesa stër – është bërë produktive në gjuhën e shkrimit.<sup>10</sup> Edhe në fjalëkrijimet e I.Kadaresë, ku merr pjesë parashtesa stër –, ndihet njëlloj ngjyrimi libror.

## Prapashtesimi

*Formimi i neologjizmave emërore me prapashtesim*

Për formimin e fjalëkrijimeve emërore Kadareja përdor disa prapashtesa : Prapashtesat - tar, - ar, përdoren për të formuar emra të përgjithshëm njerëzish sipas një pune që kryejnë: darkëtar, drekëtar, kanuntar, ankimtar, varrimtar ose sipas një gjendjeje në të cilën ndodhen: pushimtar, humbëtar, ngazëllimtar, rënkimtar, vdekëtar.

Në gjuhën shqipe me prapashtesën – tar formohen (prej emrash) emra që tregojnë njerëz të karakterizuar sipas një veprimi që kryejnë: dëshmitar, lajmëtar.<sup>11</sup>

Te Kadareja emrat me tar- shënojnë njerëzit jo vetëm sipas veprimit që kryejnë, por edhe sipas gjendjes në të cilën ndodhen. Këta emra formohen jo vetëm nga tema emërore, por edhe nga tema foljore : vdekëtar (nga pjesorja vdekë) ; humbëtar (nga pjesorja e shkurtër humbë). Këto kuptime emrash pasivë nga tema foljore, përbëjnë shmangie nga e zakonshmeja gjuhësore. Formimi i tyre nuk ndjek ndonjë gjedhe të njohur formale apo semantike. Duke qenë fjalë të reja, të formuara në rrugë të reja, ato bien më tepër në sy.

Me prapashtesat – ri, -si- shmëri, - llëk, formohen emrat : breshkëri, gurëri, qelqëri, shurdhëri, turpëri, zhurmëri, boshëri, plotshmëri, jetimllëk. Të gjithë janë emra abstraktë me përjashtim të emrit gurëri që ka kuptim konkret, kolektiv : Ajo gurëri e madhe ishte e gjitha në pritje (Ura, f. 99).

---

f. 60-103.

9 Ky ngjyrim libror i njihet parashtesës super- dhe në FGJSSH, 1980.

10 Shih : A.Xhuvani – E.Çabej, Prapashtesat e gjuhës shqipe, BSHSH, 1956,f.4.

11 Ky përcaktim është marrë në “Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme shqipe”, Tiranë,1976, f. 10.

Është fjala për urën e ndërtuar që cilësohet si një masë gurësh.

Prapashtesat – llëk dhe – ri paraqiten sinonime në formimet jetimllëk e jetimëri.

Me prapashtesat – im, – je, formohen emra si : hovëzim, qartësi, shkëndijim, yllëzim, yllësim, tallazitje. Me përjashtim të temave tallazis e qartësoj temat e tjera, që kanë shërbyer për formimet e sipërpërmendura, nuk ekzistojnë realisht në gjuhë, por duhen menduar si paraardhëse të mundshme të këtyre fjalëkrijimeve. Kështu shkëndijim, rrjedh nga shkëndijoj, hovzim nga hovzoj. Të reja janë fjalët e përdorura, të reja janë dhe temat formuese. Prapashtesa – ist përdoret në formime, si: pragist, qamilist, varshavist e ndonjë tjetër.

Fjalët pragist e varshavist shënojnë persona që kanë qënë me studime në Varshvë ë në Pragë dhe janë ktyer që andej. Kemi të bëjmë kështu, me një përdorim të veçantë të prapashtesës. Në këtë rast nuk bën në strukturën kuptimore të fjalës primitive ato modifikime për të cilën është e specializuar në gjuhën tonë.<sup>12</sup>

Prtej që në fjalët pragist, varshavist prapashtesa-ist të jepte idenë e një drejtimi politik (si në rastet marksist, fanolist etj.), por nuk ndodh kështu. Formimi i shmanget modelit semantik dhe për këtë tërheq vëmendjen. Ndërsa në fjalën qamilist prapashtesa kryen një funksion kuptimor të njohur. Fjala e formuar me anë të prapashtesës – ist shënon ndjekësit e ideve të Haxhi Qamilit.

Prapashtesa -ishte takohet në formime, si: gështenjishte. Në këtë rast formohet një fjalë me kuptim abstrakt që shpreh një cilësi të abstraguar nga shfaqjet e saj konkrete. Në fjalëkrijimin gështenjishte prapashtesa-ishte nuk del me kuptimin e saj të zakonshëm. Me prapashtesën -ishte zakonisht formohen emra topikë që e përmbajnë me shumicë atë që tregohet në fjalën primitive: ahishte, ullishte etj.<sup>13</sup>

Ndërsa prtej që fjala gështenjishte të shënonte “pyll gështenjash”, ajo shënon një cilësi që ka të bëjë me ngjyrën gështenjë. Në këtë formim ndiqet një model i njohur ndërtimor : gështenjë+ ishte. Struktura të tilla ekzistojnë. Përdorimi është i ri. Në të vërtetë fjala ka aftësi evokuese të dyfishtë. Ajo ka dy kuptime: Sipas modelit ekzistues ka kuptimin “pyll gështenjash”. Sipas përdorimit shënon cilësi. Fjala në tekst fiton një kuptim tjetër. Kjo lojë e hollë nuancash i bën tërheqëse këto fjalë. Ato evokojnë dy gjëra njëkohësisht. Ka në to mospërputhje midis modelit të formimit, idesë leksiko-semantike që sugjerojnë dhe përdorimit real të tyre.

Prapashtesa -(ë)s/- es merr pjesë në formime si: drekues, gërmërës,

12 Sipas “Fonetika dhe ...” me-ist formohen grupe fjalësh me kuptime krejt të ndryshme nga kuptimet e fjalëve të sipërpërmendura : varshavist e pragist.

13 Kjo gjë pohohet në “Fonetika dhe gramatika...”, Tiranë, 1976, f.102 dhe në “Prapashtesat e gjuhës shqipe” të Xhuvani-Çabejt, BSHSH, 1956,4.



kundërshtues, pasës, prangues, mungonjës. Siç shihet, me këtë prapashtesë formohen emra njerëzish të karakterizuar sipas veprimit që bëjnë: drekues, kundërshtues, prangues, sipas një gjendjeje: mungonjës. Formimi gërmërës, me kuptimin e tij, bën përjashtim nga rregulli i përgjithshëm sipas të cilit formimet me -(ë)s tregojnë njerëz të karakterizuar sipas veprimit që kryejnë ose profesionit a punës që bëjnë.<sup>14</sup>

Me prapashtesën -ak formohen emra, si hënak. Me këtë fjalë shënohet një njeri sipas punës që kryen (vrojton hënën). Kemi të bëjmë me një formim origjinal, meqë në gjuhën tonë, zakonisht, prapashtesa-ak nuk përdoret për të formuar emra njerëzish sipas punës që bëjnë.<sup>15</sup>

Një prapashtesë tjetër që përdoret në formimin e fjalëve të reja është dhe -an: mjeran, shkurtan, shkretan. Sipas një rregulli të njohur, në kësi rastesh formohen mbiemra prej mbiemrash.<sup>16</sup>

Në prapashtesën -izëm formohet emri makbetizëm. Fjala shënon tipar abstrakt që lidhet kuptimisht me fjalën Makbet. Me -imë formohet sterrimë (nga sterroj).

Prapashtesa -or përdoret për të formuar emrat: rrugor, uJOR, shtrigor. Në dy rastet e para formimi ndjek një rregull të njohur, formohen emra të përgjithshëm njerëzish të karakterizuar sipas punës që bëjnë. Në rastin shtrigor morfema -or shërben si prapashtesë mocioni, formon trajtën e gjinisë mashkullore të emrit shtrigë: Sikur ta kishin prekur një mijë shtriga e shtrigorë (Ura, f.226).

Me prapashtesën -najë formohen emra kolektivë, disa prej të cilëve kanë dhe përdorim topik si yllnajë.<sup>17</sup> Formimet me -najë të I.Kadaresë kanë dhe ngjyrimë emocionale: fjala thashethemnajë shënon masë thashethemesh, një masë pushtuese dhe mbytëse. Po kështu shpendnajë mbart ngjyrimë emocioanle-poetike që ia përforcon konteksti:

*Ishte një vend që quhej Shqipëri, që në përkthim do të thoshte pak a shumë "shoqëri shqipesh", një farë **shpendnajë** me pupla të përgjakura nëpër erë, rrebesh...* (Ura, f.280)

Tërësia e shpendëve dhe vendi i grumbullimit të tyre, që shënohen nga fjala e re, janë përfytyrime. Natyra përfytyruese e bën fjalën akoma më shprehëse.

Në formimin e neologjizmave emërore një mënyrë prodhimtare është

14 Formime të tipit kuptimor gërmërës nuk përshkruhen as në "Fonetika...", as në "Prapashtesat e gjuhës shqipe" te Xhuvani- Çabejt, as në "Gramatika e gjuhës shqipe", Tiranë, 2002, f. 133.

15 Një funksion i tillë nuk i njihet kësaj prapashtese në veprat e sipërpërmendura.

16 Shih: "Prapashtesat e gjuhës shqipe", Xhuvani-Çabejt, BSHSH, 1956, 4.

17 Një model i tillë formues është i njohur në gjuhën shqipe. Shih: Xhuvani-Çabejt: "Prapashtesat e gjuhës shqipe", BSHSH, 1956, f.4.

kompozimi. Edhe këtu gjejnë vend formimet originale që nuk ndjekin modele të njohura. Kështu në formimet me kompozim ka raste që në kompozitë përfshihen fjalë shërbyese. Ndërsa dihet që në formimin e një kompozite (fjalë e përbërë) marrin pjesë vetëm tema fjalësh emërtuese. Fjalë shërbyese mund të ketë vetëm në fjalët e përngjitura.<sup>18</sup>

Krijimet e I.Kadaresë nuk mund të jenë fjalë të përngjitura, të cilat formohen historikisht në gjuhë e jo në procesin krijues ku mund të lindin vetëm fjalë të përbëra<sup>19</sup>. Ky kompozim ku marrin pjesë dhe fjalë shërbyese është i përkohshëm, kontekstual, ka vlerë brenda veprës. P.sh.: asnatasditë:

*Zogjtë e rrallë fluturojnë ultas mbi të, mbi atë asnatasditë pikëllimtare* (Ura, f. 400).

Ose: tej jetshmëri, tejvdekje: *Kjo thashethemnajë për ngritjen e Kostandinit nga varri s'kishte të bënte me një trazim misterioz, që trazon herë pas herë si një duhmë shpirtrat njerëzore, i bën... të trallisën duke synuar.. drejt tejtjetshmërisë apo tejvdekjes (Gjakftohtësia, f. 158). Dy fjalëkrijimet e përdorura në këtë thënie janë gjetje vetëm për këtë përshkrim psikologjik. Edhe mënyra e formimit të tyre, ndryshe nga modelet e njohura, flet për natyrën e tyre rastësore.*

Një shmangje nga modeli i zakonshëm formues përbën dhe formimi zerokrejt, ku rendi i gjymtyrëve është i kundërt në krahasim me rendin e zakonshëm në kompozimin ndajfolje – emër (keqbërës, derjtshkrim) etj. Kadareja krijon një numër kompozimesh emërore të përbëra nga një emër dhe një mbiemër:<sup>20</sup> burrëvdekur, mjegullkaltëror etj. Ka dhe ndonjë formim origjinal me rend të kundërt të gjymtyrëve emër e mbiemër. Mbiemri vendoset para emrit, ndryshe nga formimet e llojit mjegullkaltëror. Një tip i tillë formimi nuk përshkruhet për gjuhën shqipe.<sup>21</sup> Kompozitat mbiemër+emër bien menjëherë në sy si formime të pazakonshme, shembull: *Keltët, shqiptarët, baskët, skocezët...ai i quante kaltëroralpinë*.<sup>22</sup> Vendosja e mbiemrit, si fjalë përcaktuese, para emrit (fjalë e përcaktuar) përbën shmangje (nga norma) në ndërtimet e kësaj natyre.

Në kompozitat emërore gjymtyrët vendosin midis tyre marrëdhënie

18 Shih: "Fonetika dhe...", Tiranë, II, 1967, f. 45 dhe 50; ose: "Gramatika e gjuhës shqipe" I, Tiranë, 2002, f. 75.

19 Fjala kompozitë përdoret në kuptimin fjalë e përbërë si në "Gramatika e gjuhës shqipe" I, 2002, f. 70 - 74.

20 Në "Gramatika e gjuhës shqipe I" (Tiranë, 2002) kompozimet e ndërtuara me një gjymtyrë mbiemërore shihen si një tip joproduktiv. Ndërsa A.Kostallari, me argumente e shembuj të shumtë provon që një tip i tillë kompozimi është produktiv në gjuhën shqipe. (Shih: A.Kostallari: "Mbi leksikun dhe formimin e fjalëve", Tiranë, 1972, f.75-90.

21 Në "Gramatika e gjuhës Shqipe" I (Tiranë, 2002) për emrat e formuar me kompozim nuk jepet asnjë model mbiemër+emër.

22 Koha e shkrimeve, f. 204.

këpujore ose përcaktore. Të dyja llojet, këpujore e përcaktore, parapëlqehen pothuaj njësoj. Ja disa shembuj kompozitash të ndërtuara me bashkërenditje e me nënrenditje gjymtyrësh: delegacion-kalë, kasolle-muze, karrocë-lavire, çerekshtëpi, ëndërrparës, ferexhekarvan, ferexheferman, gjuhëkrisht, gjeneraliman, këmishënatë, krimbdëgjim, nulgjuhë, nulkujtesë, ndihmësmunxadhënës, vakëflënës etj.

Kompozitat kanë një ngarkesë semantike më të madhe se fjalët e prejardhura dhe e paraqesin më qartë nocionin që shprehin.

Neologjizmat emërore, Kadareja i formon dhe me konversion, rrugë formimi kjo –e re dhe e pazakonshme. P.sh.:

*Ajo ndjeu si u sajua brenda saj një zbrazëti e re, pastaj në atë **bosh** se nga mbinë afishet e shqyera* (Koha, f.191).

*Ismail Qemali kishte ikur duke lënë një bosh të madh* (Koha, f.352).

*Kurse mbrëmë, sikur ta kuptonte dhe vetë boshin...ai e shkeli zakonin* (Gjakftohtësia, f.290).

Në këto raste emri bosh rrjedh nga ndajfolja bosh, që kalon në klasën e emrave pa pësuar asnjë shndërrim fonetik.

## Formimi i neologjizmave mbiemërore

Në prozën e shqyrtuar të Ismail Kadaresë përdoren rreth 67 neologjizma mbiemërore. Tipi formues më produktiv për fjalët mbiemërore është ai prapashtesor. Përdoret një larmi prapashtesash, pothuaj krejt prapashtesat më të përdorshme për formimin e mbiemrave në gjuhën tonë. Me prapashtesën -or formohen mbiemra, si: akullsor, beqaror, çmenduror, floknor, kështjellor, mbrëmësor, mynxyror, nofullor.

Formimet ndjekin modele të njohura gjuhësore. Prapashtesa -ian përdoret në formime, si: ainshtainian, (natë)bukureshtiane. Edhe për këto formime janë shfrytëzuar gjedhe të gjuhës sonë: shespirian, evropian.<sup>23</sup> Prapashtesa -tar përdoret për të formuar fjalët: fillimtar, ngazëllimtar, shkretimtar (sipas modelit vendimtar). Prapashtesa -an përçon ngjyrimin e saj negativ në formimeve, si humbaman. Po me ngjyrimet negative del prapashtesa -an në formimet: shurdhan, zymtan.<sup>24</sup>

Në fjalën idiotesk përdoret prapashtesa -esk, prapashtese me prejardhje të huaj.

Takohen disa formime me prapashtesën -(ë)s/es: trallisës, shkëndijues

23 Shih: Në "Gramatika e gjuhës shqipe I" (Tiranë, 2002), f. 192.

24 Prapashtesa - aman nuk përshtet në "Gramatika e gjuhës shqipe I" (Tiranë, 2002); Xhuvani - Çabej e trajtojnë prapashtesën -an ndër konglutinatet e saj (anac, anec), nuk përmendet - aman. Prapashtesës -an nuk i njihet ndonjë aftësi ngjyrorëse emocionale. Shih: Xhuvani - Çabej, "Prapashtesat e gjuhës shqipe", BSHSH, 1956, 4.

(sipas modelit mbytyës, rrëmbyes). Me prapashtesën-ar, formohet fjala zymtar, (nga i zymtë). Formimi nuk ndjek ndonjë model të njohur. Me -ar formohen, zakonisht, mbiemra nga emrat.<sup>25</sup> Në rastin zymtar prapashtesa -ar shton vetëm ngjyrimë emocionuese në kuptimin e temës formuese i zymtë. Formimet mbiemërore, në rastet më të shumta, bëhen sipas rregullave të njohura. Përjashtimet, që u vunë në dukje, janë të pakta.

Neologjizmat mbiemërore formohen dhe me kompozim. Temat, që bashkohen në një fjalë të vetme, lidhen midis tyre me bashkërenditje (lugato-xhindëror, mjegull-pasternakore) por më shumë me nënrenditje (barkngushtë, krimbdëgjues, popullngrënës, leshrabaltë).

Një grup i vogël mbiemrash formohen me paranyjëzim: i besëtuar, i gurëzuar, i dimëruar, i dimensionuar, i truallzuar, i frikur. Në pamje të parë formimet duken të rregullta: paranyjëzohet pjesorja e foljes përgjegjëse. Por, po të vështrosh vetë foljet primitive, ato në disa raste janë fjalëkrijime: dimensionoj, truallzoi, besëtoj (nga dimension, truall, besë).

Me paranyjëzim e prapashtesim njëherazi janë formuar mbiemrat: i dallandyshtë, i gëlqerortë, i humbët, i hapësirshëm, i humnershëm, i kuçedërshëm, i mavijtë, i midistë, e marrëzishme, i shkretëtirtë, i trishtëm, i zhdukshëm.

Formimi i neologjizmave mbiemërore, zakonisht, ndjek gjedhe të njohura gjuhësore.

## Formimi i neologjizmave foljore

Neologjizmat foljore, në pikëpamje fjalëformuese, përgjithësisht nuk paraqesin ndonjë veçanti. Në formimin e tyre ndiqen rrugë e mjete të njohura. Por kjo nuk është e përgjithshme: mjetet formuese, në disa raste, nuk janë të njohura. Është fjala për disa tema fjalëformuese që ndeshen për herë të parë në formimet e Ismail Kadaresë, p.sh.: Në formimin enigmatizohet tema fjalëformuese është e paqartë: ky është më tepër formim analogjik, sipas modelit konkretizoj.

Po kështu në formimin vdekëron prapashtesa -ro i shtohet një temë foljore vdek- gjë që nuk ndodh zakonisht në gjuhën shqipe<sup>26</sup>.

Për formimin e neologjizmave foljore në shumë raste përdoren mjete dhe rrugë të njohura, siç është prapashtesimi. Përdoren pothuaj tërë prapashtesat më të njohura:

25 Në studimin e Xhuvanit-Çabejt "Prapashtesat e gjuhës shqipe", gjatë përshkrimit të modeleve formuese me prapashtesën-ar, në asnjë rast kjo prapashtesë nuk bashkohet me mbiemra për të formuar mbiemra.

26 Në "'Gramatika e gjuhës shqipe I' (Tiranë, 2002), f. 345, thuhet se me prapashtesën-ro, janë formuar një numër relativisht i kufizuar foljesh, kryesisht, nga tema emërore.

- o: bërrylon, ftohton, vajzërohet, vetmoj;
- ro: baltëron, krimbëron, vdekëron;
- to: borëton, nazetohet;
- zo: enigmatizohet, legjendarizohet

Larmia e mjeteve formuese, rregullsia e parregullsia e rrugëve të formimit e bëjnë grupin e neologjizmave foljore një grup që tërheq vëmendjen e që mban shenja të origjinalitetit krijues të shkrintarit. Fjalëkrijimet foljore shënojnë veprime, gjendje reale a të imagjinuara. Në rastin e imazheve (enigmatizohet, legjendarizohet) fjalëkrijimi paraqitet më sugjestiv.

### **Formimi i neologjizmave ndajfoljore**

Ndajfoljet paraqiten një grup më i larmishëm dhe më i gjerë se foljet. Numërohen rreth 31 krijime ndajfoljore. Në formimin e tyre përdoret mënyra prapashtesore e konversioni. Prapashtesat ndajfoljore fjalëformuese, që përdor Kadareja, janë : -isht, -azi, -thi. Këto janë mjete të njohura e të përdorshme në mbarë gjuhën. Të gjitha formimet me -isht bëhen sipas modelesh të njohura. Kjo ka të bëjë si me zgjedhjen e temës primitive, ashtu dhe me zgjedhjen e afiksit e të mënyrës së lidhjes së tij me temën: argjendërisht, butësisht, dëshpërimisht, hipokrizisht, monotonisht, zymtësisht, zbehtësisht. Si baza fjalëformuese kanë shërbyer emra abstraktë të formuar me prapashtesat: -si, -ri, -im: argjendëri, butësi, dëshpërim, hipokrizi, monoton, zymtësi, zbehtësi dhe mbiemra: kaotik, katastrofik.

Emri argjendëri, me kuptim abstrakt, është gjithashtu një neologjizëm, një temë fjalëformuese e re, e pazakonshme.

Me prapashtesën -azi formohen ndajfoljet: çrregulltazi, shurdhtazi nga temat mbiemërore: i çrregullt, i shurdhët. Në këto raste e re është fjala, që formohet, rruga dhe afikset janë të njohura, jo të reja. Ndajfolja vajtımthi formohet me prapashtesën -thi nga tema emërore vajtım (formimi është i rregullt, sipas modelesh të njohura).

Rreth 16 ndajfolje formohen me çnyjëzim të mbiemrit përgjegjës. Kjo është një mënyrë e njohur në gjuhën shqipe. Formime të tilla përdoren sot, kryesisht, në stilet e shkruara e në letërsinë artistike. Veç modeli formues është i të folmeve veriore. Ja disa shembuj: frikshëm, hutueshëm, humbshëm, kujdesshëm, mundimshëm, mallëngjyeshëm, ngutshëm, ngadalshëm, shkretueshëm, shqetësueshëm, trembshëm, vëmendshëm, thirravajshëm, etj.

Në disa prej këtyre rasteve kemi shmangie nga formimi i zakonshëm normativ. Shmangia ka të bëjë me temën formuese e cila është e paqenë në gjuhën tonë. Tema mbiemërore, si: i humbshëm, i thirravajshëm, i trembshëm mungojnë në gjuhën shqipe. Prandaj mund të mendohet

që formimi i ndajfoljeve përgjegjëse nuk është nisur nga fjalë të tilla, që nuk kanë mundësi motivuese (përderisa nuk gjenden në gjuhë), por ka ndodhur për analogji me formimet që nisen nga mbiemrat e që motivohen me mbiemrat (ngadalshëm etj.).

### PËRDORIMI I NEOLOGJIZMAVE

Fjalëkrijimet e Kadaresë kanë shumë përdorime. Ato takohen dhe në gjuhën e autorit, dhe në gjuhën e personazheve. Në gjuhën e personazheve janë më të pakta. Përdoren sidomos kur gjuha dhe mendimet e personazhit jepen në ligjëratë të zhdrejtë:

*Ato lindin të vdekura, tha ai dhe jetojnë të vdekura (ai, përdori fjalën vdekërojnë gjatë gjithë jetës) gjersa vjen koha e rrënimit të tyre, e stërvdekjes, siç tha ai (Ura,71).*

*Atij i pëlqente të fliste për ata popuj të vegjël...të cilët ai i quante kaltëroralpinë (Koha, 204). Antiledimakbeth, gruaja e tij rrinte mendueshëm mbi kanape (Koha, 236).*

Ndodh dhe që fjala e re të përfshihet në ligjëratën e drejtë të personazhit:

*- Po ata harruan se ky vend quhet Shqipëri dhe jo Breshkëri apo Krimbëri (Dimri,345).*

Gjuha e autorit përmban shumë më tepër neologjizma se gjuha e personazheve. Ato kryejnë disa shërbime. Autori përdor neologjizma për të karakterizuar personazhet. Karakterizimi ka të bëjë me portretin moral, me portretin fizik, me profesionin etj. Duke përdorur neologjizma për karakterizim, tiparet jepen më të dukshme, të theksuara, më të gjalla e në mënyrë të veçantë. Ja disa shembuj:

*Ashtu leshrabaltë e me rroba të ndranguara, vazhduan udhën më tutje (Ura,24).*

*Sa herë që në qiell shfaqej ndonjë re, koka shkëndijuese e konstruktorit ngrihej me shqetësim (Ura,39).*

*Sytë të hapur, të shkretëtirtë...(Ura,117).*

*Beni kishte mbetur i mbështetur pas murit, me sytë inatçorë të mbërthyer mbi trotuar (Dimri, 46).*

*Gjithçka tek ai ishte nofullore (Ura,470).*

*E pashë që larg midis turmës së njerëzve, tek vinte me atë hënëzim të përhershëm mbi krye (Ura,506).*

*Befas, midis dhjetëra syve, doktoreshën e tërhoqi një shkëndijim këmbëngulës (Koha, 226).*

*Pati ndjesinë se sytë **qelqanë** të plakës i kishte akoma pas shpine (Dimri, 87).*

*Në mollëzat e fytyrës kishte një kuqëlim **ngazëllimtar** (Dimri 107).*

*Te bërryli i tij u përplas lehtë një **shkurtan** (Dimri,142).*

*Ndoshta ngaqë **u vajzërua** në një kohë të turbullt ... për të s'kishte arritur të thuhet akoma ndonjë historizë ...(Ura,92).*

Neologjizmat e nënvizuara në thëniet e mësipërme përdoren në portretizimin fizik të personazheve të ndryshme. Pjesëmarrja e tyre në portretizim i paraqet portretet jo në pamje të zakonshme, siç jemi mësuar t'i shohim në përditshmërinë tonë; kjo i spikat ato dhe i fikson, me dashje ose pa dashje, në kujtesën tonë.

Në prezantimin fizik përdoren fjalë klasash të ndryshme leksiko-gramatikore, jo vetëm mbiemra e emra, por edhe ndonjë folje që paraqet gjendje fizike (u vajzërua)...

Neologjizma takohen dhe në portretizimin moral të personazheve, në paraqitjen e vetive të karakterit, të impulseve të brendshme, të botës psikologjike. Në komentet e tij logjike e psikologjike autori përdor herë pas here neologjizma. Si mjete më shprehëse, neologjizmat ndihmojnë që logjika e personazheve të paraqitet në veçantinë e në origjinalitetin e saj, me momente kulminante, në pulsime të përhershëm, me mbingarkesa e patologjira:

*Duke ikur...nga zona epike ... ata **vetëçheroizoheshin** dhe i humbnin cilësitë e tyre të mirëfillta (Gjakftohtësia, 234);*

*U zbulua se Ahmet Zogu, sulltani **popullngrënës** i Shqipërisë kishte blerë në Vjenë një pallat...(Kronikë, 26).*

*Haxhi Mileti kishte një gjendje shpirtërore të gëzueshme e të shpërqëndruar, diçka **të dallëndyshtë** që ia bënte të lehtë gjithçka (Koha,133).*

*Ndjente valet e zilisë **zymtare** që e lëpinin herë pas here (Ura, 191).*

*Ishte më tepër një mënjanim, apo fazë e parë e një farë **tëhuajzimi** (Gjakftohtësia, 255).*

*Në kokë ai kishte një qetësi të çuditshme, më tepër një zbrazëti **shurdhane** (Gjakftohtësia, 354).*

*Ajo ndjeu se si u sajua një zbrazëti e re pastaj në atë **bosh** se nga mbinë afishet e shqyera (Koha, 181).*

*... do të vinte dita kur ata, që aq shumë dhe aq **lodhshëm** ishin urryer, do të duheshin më në fund (Koha, 201).*

*Shestani vështronte pikëllueshëm atë vithisje (Koha, 297).*

*Sa i mjerë dhe naiv dukej njeriu që do të arrestohej në gëzimin e tij mbrëmësor. (Dimri, 267).*

*Ai dhe familja e tij në çdo 5 muaj.. çonin kurora hipokrizisht mbi varrin e një partizani (Dimri, 385).*

*Diçka i humnerohej here pas here brenda vetes (Gjakftohtësia, 238).*

Përshkrimi i gjendjes shpirtërore e mendore të personazheve është nga momentet më me jetë të krijimit. Ky portretizmi logjik – emocional është gjithashtu i vështirë për t'u realizuar. Neologjia është një ndër rrugët efikase, neologjizmat janë mjete tepër efektbërëse në përshkrimet e botës mentale – shpirtërore të personazheve. Krijimi i fjalëve të reja është një gjetje me vlerë që ndihmon për një paraqitje sa më të gjallë dhe ndikuese të prirjeve, gjendjeve e predispozitave psikologjike e mendore të personazheve.

Akoma më gjerësisht përdoren neologjizmat në përshkrimet (në pasazhe përshkruese). Për ta sjellë në libër jetën e gjallë me përmasat e saj reale hapësinore e kohore autori u drejtohet shpesh thënieve përshkruese. Në thënie të tilla gjen dhe neologjizma që me ngjyrat e tyre të spikatura i japin sfondet hapësinore e kohore më të ndriçuara e në funksion të gjallërimit jetësor: nganjëherë nën rezet e diellit **mbrëmësor** koka e tij kuqalashë dukej sikur lëshonte shkëndija **djellëzore** (Ura, 32).

*Atij i pëlqente të sodiste në paqe ndriçimin akullsor të hënës (Ura, 128).*

*Një zallishte shfaqej hapësirshëm poshtë tij (Koha, 151).*

*Gjithë dekori lugato – xhindëror i Mesjetës nuk ishte veçse një maskë për të mbuluar të vërtetën (Emblema, 65).*

Bashkë me përshkrimin e mjediseve hapësinore bëhet dhe prezantimi i objekteve që gjenden në to. Edhe në këtë rast ndodh që të përdoren neologjizma, kështu objektet dalin në një dritë të re:

*Pjesa kështjellore e shtëpisë gjirokastrite është vetëm gjysma e saj e poshtme.... pjesa tjetër ka krejt ato mjedise ylberore që raspodi verior ... i ka përshkruar në eposin e tij (Koha, 370).*

*U përpoq t'i përfytyronte ashtu siç ishin, një këtu, një atje, **zymtane** dhe idhnake, me frëngjitë e zeza dhe portat e kyçura nga brenda (Gjakftohtësia, 305).*

Neologjizmat, që përdoren në përshkrimin e objekteve (dhomës gjirokastrite e kullës malësore), luajnë rol të dukshëm në vizatimin e tyre sa më poetik e shprehës.

Ja dhe disa shembuj të tjerë ndërtimesh me neologjizma që përdoren



për spikatje hapësirash:

*Me orë të tëra vështronte ultësirën e **dimëruar** (Ura, 225).*

*Gjithçka ishte e ndryshme nga ajo ditë **mjegullo – pasternakore** (Ura, 476).*

*Tek ajo dhomë hynin rrallë. **Boshësia** e saj i futi dridhmën (Koha, 273).*

*Kurse kjo pllajë ishte aq e **hapësirshme** sa mund të ndiheshe si të doje (Koha, 292).*

*Më tutje fusha e përmytur **baltëronte** shkretueshëm (Koha, 355).*

*... mes asaj **baltisjeje** të përgjithshme (Ura, 32).*

*Hieroglifet e ndezura...spikatnin kërcënueshëm si merimanga të gjelbra në sfondin e **shkretëtirtë** të qiellit (Dimri,180).*

*Poshtë, midis mjegullës, qe dukur një copë tokë dimërore me një relief të **përçudur** (Dimri, 220).*

*Ishte po ai qiell nëntori, **sterrimë** e vërtetë (Dimri, 414).*

*Në këtë yrt të humbur dhe ters, ku mbaron hapësira islamike, nën **jetimllëkun** e qiellit, përballë detit...(Dimri, 455).*

*Por kishte mundësi që të vritej përpara se të mbyllej në atë **gurëri** (Gjakftohtësia, 276).*

Me neologjizma shënohen dhe disa nocione që lidhen me kohën, epokat:

*Kaloi e mërkura, e enjtja. Pastaj e **premteshtunediola** (Kronikë, 160).*

*...Pas kanatit gjysmë të hapur... shihej qielli i vrenjtur i **fundvjeshtës** (Gjakftohtësia, 125).*

*Së shpejti do të hynte prilli...**Prillmort** (Gjakftohtësia, 310).*

Idetë që shënohen nga këto neologjizma janë të reja ose pjesërisht të reja (prillmort, e premteshtunediola). Në ndonjë rast të rrallë përdorimi i neologjizmit krijon efekt komik:

*Trashëgimtarët e qiramarrësve të shtëpive e **çerekshtëpive** u dëshpëruan.*

## NEOLOGJIZMAT Ë PËRDORURA NË PROZËN E I.KADARESË

(Fjalorth)

Shënim 1: Shkurtime të përdorura në listën e mëposhtme kanë kuptimet respektive:

em. – emër; mb. – mbiemër; f. – folje; nd. – ndajfolje; par. – formim parashtesor; prap. – formim prapashtesor; komp. – formim me kompozim; konv. – formim me konversion.

Shënim 2: Si kriter kryesor për të përcaktuar statusin e një neologjizmi është marrë përfshirja ose jo në Fjalorin e Gjuhës Shqipe, Tiranë, 1980.

Ankintar, em.	Ura..., f. 19, prap.
Anonimat (hapash), em.	Ura..., f. 99, prap.
Akullsor, mb.	Ura..., f. 128, prap.
Akullsirë, em.	Koha e ..., f. 337, prap.
Antiskënderbejadë, em.	Koha e..., f. 247, prap.
Argjendërisht, nd.	Ura ..., f. 267, par.
Asnatasditë, em.	Ura..., f.400, komp.
Avionkalëbaladash, em.	Ura..., f. 510, komp.
Antiledimakbeth, em.	Koha..., f. 236, par.
Avio-lejlekoflutur, em.	Kronikë..., f. 108, komp.
Antishekspir, em.	Dimri..., f. 564, par.
Antibethoven, em.	Dimri..., f. 564, par.
Ajnshtajnian, mb.	Dimri..., f. 609, prap.
Borëton, f.	Ura..., f. 44, prap.
Bezdisshëm, nd.	Koha, f. 75, prap.
Biojetë, em.	Ura..., f. 278, komp.
Bashtepsi, em.	Ura ..., f. 329, komp.
Bashbakllava, em.	Ura..., f. 334, komp.
Barkngushtë, mb.	Emblema..., f.141, komp.
Beqaror, mb.	Emblema..., f. 152, prap.
Bosh, i, em.	Koha... f. 181,353; Gjakftohtësia, f. 290, konv.
Boshëri- a, em.	Koha..., f. 246; Gjakftohtësia, f. 231, prap.
Baltëron, f.	Koha..., f. 355, prap.
Bashëndërror, em.	Gjakftoht..., f. 512, komp.
Bashëndërr, em.	Gjakftoht..., f. 513, komp.
Botëpushtues, mb.	Kështjella, f. 22, komp.
(natë) bukureshtiane, mb.	Dimri ..., f. 171, prap.
Breshkëri, em.	Dimri..., f. 345, prap.
Burrëvdekur, mb.	Dimri..., f. 51, komp.
Baltisje, em.	Ura..., f. 32, prap.
Baltak, mb.	Ura..., f. 3, prap.
Bërrylon, f.	Dimri ..., f. 191, prap.

Çmenduror, mb.  
 Çmishëron, f.  
 Çerekshtëpi, em.  
 Çjetë, em.  
 Çrregulltazi, nd.  
 I dallëndyshtë, mb.  
 Dëshpërimisht, nd.  
 Drekuës, em.  
 Drithëtirë, em.  
 Dykrishteri, em.  
 Darkëtar, em.  
 Dëfrimtar, em.  
 Drekëtar, em.  
 I dimensionuar, mb.  
 E dimëruar, mb.  
 Delegacion-kalë, em.  
 Diferencial, em.  
 Enigmatizohet, f.  
 E premteshtunedielës, em.  
 Ëndërrparës, em.  
 E Fillimta, mb.  
 I Furtunshëm, mb.  
 Ftohton, f.  
 Floknore, mb.  
 I frikur, mb.  
 Ferexhekarvan, em.  
 Ferexheferman, em.  
 Fundvjeshtë, em.  
 Flamurleshprer, em.  
 Grambulues, em.  
 I gurëzuar, mb.  
 I gëlqerortë, mb.  
 Gurëri, em.  
 Gërmërës, em.  
 Gështjenjishtë, em.  
 Gjakmarrjelogji, em.  
 I Gjithëgjendshëm, mb.  
 Gjysmëlegjendar, mb.  
 Gjuhë-krisht, em.  
 Gjysmëorë, em.  
 Gjeneraliman, em.  
 Gjakftoht..., f. 296, prap.  
 Dimri ..., f. 596, par.  
 Emblema..., f. 177, komp.  
 Ura..., f. 273, par.  
 Koha..., f. 245, par.+ prap..  
 Koha..., f. 133, nyjë+prap.  
 Ura..., f.34, 117, prap.  
 Gjakftoht..., f. 258, prap.  
 Gjakftoht..., f. 46, prap.  
 Gjakftoht., f. 157, prap.  
 Dimri ..., f. 136, prap.  
 Dimri ..., f. 139, prap.  
 Ura ..., f. 486; Koha..., f. 389, prap.  
 Ura..., f. 473, paranyjëzim  
 Ura..., f. 225, paranyjëzim  
 Koha..., f. 119, komp.  
 Koha, f. 234, prap.  
 Gjakftoht..., f. 255, prap.  
 Kronikë ..., f. 160, komp.  
 Gjakftoht..., f. 518, komp.  
 Ura ..., f. 254, prap.  
 Ura ..., f. 35; Embl..., f. 108.  
 Dimri ..., f.50, 26, prap.  
 Koha..., f. 236, prap.  
 Koha..., f. 219, paranyjëzim  
 Koha..., f. 140, 150, komp.  
 Koha ..., f. 129, komp.  
 Gjakftoht..., f. 125, komp.  
 Dimri ..., f. 22, komp.  
 Koha..., f. 151, komp.  
 Dimri..., f.463, Ura ..., f. 167, paranyjëzim  
 Ura..., f. 91, nyjë+ prap.  
 Ura..., f. 99; Gjakftoht. f. 276 prap.  
 Ura ..., f. 290, prap.  
 Dimri..., f. 285, prap.  
 Gjakftoht..., f. 296 komp.  
 Ura..., f. 31; Dimri ..., f. 574; Koha..., f. 66  
 nyjë+prap  
 Ura..., f. 334, komp.  
 Ura ..., f. 252, komp.  
 Ura ....f.154, komp.  
 Dimri..., f. 453, komp.

Gjysmëroman, em.  
 Gjysmëpërgjumje, em.  
 Gjakftohtësisht, nd.  
 Hënak, em.  
 Hovzim, em.  
 Hetueshëm. nd.  
 Humnerohet, f.  
 Hënëzim, em.  
 Hiçkatran, em.  
 I hapësirshëm, mb.  
 Hovzim, em.  
 Humbëtar, em.  
 Humbaman, mb.  
 Hipokrizisht, nd.  
 I humnershëm, mb.  
 Humbshëm, nd.  
 Hëna-kako-pino, em.  
 Idiotesk, mb.  
 Jetimëri, em.  
 Jetimllëk, em.  
 Kasolle-muze, em.  
 Këmishënatë, em.  
 Krimbdëgjues, mb.  
 Krimbdëgjim, em.  
 Kaotikisht, nd.  
 Katërllëk, em.  
 Kështjellor, mb.  
 Katastrofikisht, nd.  
 Kujdesshëm, nd.  
 Kryemunxëdhënës, em.  
 Krimbëron, f.  
 Kalëdhuratë, em.  
 Kryqor, mb.  
 Kundërshtues, em.  
 Komuntar, em.  
 Karrocë –flutur-arkivol, em.  
 I kuçedërshëm, mb.  
 Karrocë-lavire, em.  
 Korridoriadë, em.  
 Kaltëroralpin, em.  
 Lejleko-flutur, em.  
 Lugato-xhindëror, mb.  
 Koha..., f. 36, komp.  
 Koha..., f. 37, komp.  
 Koha..., f.381, prap.  
 Emblema..., f. 159 prap.  
 Gjakftoht..., f. 294, prap.  
 Gjakftoht..., f. 207; Dimri..., f. 190, prap.  
 Gjakftoht..., f. 238, prap.  
 Ura..., f. 506, prap.  
 Ura ..., f. 346, komp.  
 Ura ..., f. 285; Koha..., f. 151, 292, nyjë + prap.  
 Ura ..., f. 255, prap.  
 Ura..., f. 202,176; Koha...f. 328, prap.  
 Ura..., f. 158, prap.  
 Dimri..., f. 385, prap.  
 Dimri..., f. 591, nyjë+prap.  
 Koha ..., f. 323, prap.  
 Kronikë ..., f. 209, komp.  
 Ura..., f. 358, prap.  
 Ura..., f. 278,100, prap.  
 Dimri.....f. 455, prap.  
 Emblema..., f. 196, komp.  
 Kronikë..., f. 195; Dimri, f. 54, komp.  
 Kronikë..., f. 145, komp.  
 Kronikë..., f. 145, komp.  
 Dimri..., f.535,576; Ura..., f. 260, prap.  
 Dimri..., f. 450, prap.  
 Koha..., f. 370,373, prap.  
 Koha..., f. 251, prap.  
 Koha..., f. 301, prap.  
 Koha..., f. 161; Ura..., f. 303, komp.  
 Koha..., f.134, prap.  
 Koha..., f. 116, komp.  
 Gjakftoht..., f. 235, prap.  
 Gjakftoht..., f. 162, prap.  
 Gjakftoht..., f. 336, prap.  
 Gjakftoht..., f. 314, komp.  
 Gjakftoht..., f. 291, paran. + prap.  
 Gjakftoht..., f. 291, komp.  
 Ura..., f. 391, prap.  
 Koha..., f. 204, komp.  
 Kronikë..., f. 108, komp.  
 Emblema..., f. 65, komp.

Leshrabaltë, mb.  
 Legjendarizohet, f.  
 Mbrëmësor, mb.  
 Mundimshëm, nd.  
 Mesdimëror, mb.  
 Moscopëtim, em.  
 Mynxyror, mb.  
 Mjieran, em.  
 Mëdyshëm, nd.  
 Mosdashuri, em.  
 I mavijtë, mb.  
 I midistë, mb.  
 E marrëzishme, mb.  
 Masakroidë, em.  
 Mashkullim, em.  
 Mungonjës, em.  
 E mbijetshme, mb.  
 Makbetizëm, em.  
 Mbasnate, em.  
 Mjegullo –pasternakor, mb.  
 Mospërgjigje, em.  
 Mosgëzim, em.  
 Mjegullkaltëror, em.  
 Mjegullirë, em.  
 Monotonisht, nd.  
 Mosgjë, em.  
 Ngazëllimtar, mb.  
 Nazetohem, f.  
 Ngutshëm, nd.  
 Ngadalshëm, nd.  
 Nofullor, mb.  
 Nulkujtesë, em.  
 Nulgjuhë, em.  
 Ndihmësmunxadhënës, em.  
 Odajashtë, em.  
 Popullngrënës, mb.  
 Përbindshor, mb.  
 Paradyqanës, em.  
 I përnxirë, mb.  
 Përtejjetë, em.  
 Pikëllueshëm, nd.  
 Pambarim, -i, em.  
 Ura..., f. 24, komp.  
 Dimri..., f. 236, prap.  
 Dimri..., f. 267; Ura..., f. 32, prap.  
 Dimri..., f. 553, prap.  
 Dimri ..., f. 532, komp.  
 Emblema..., f. 151, par.  
 Koha..., f. 358, prap.  
 Koha..., f. 342, prap.  
 Koha..., f. 236; Gjakftoht..., f. 129, par. + prap.  
 Koha..., f. 174; Ura..., f. 397, par.  
 Koha..., f. 132, nyjë+prap.  
 Gjakftoht..., f. 230, nyjë + prap  
 Gjakftoht..., f. 148, 411, nyjë + prap.  
 Koha..., f. 209, prap.  
 Gjakftoht..., f. 149, 323, prap.  
 Gjakftoht ..., f. 13, prap.  
 Gjakftoht..., f. 129, nyjë + par. + prap.  
 Ura..., f. 404, prap.  
 Ura..., f. 459, komp.  
 Ura..., f. 113, komp.  
 Ura..., f. 88, par.  
 Ura..., f. 148, par.  
 Ura..., f. 205, komp.  
 Ura..., f. 228, prap.  
 Ura..., f. 296, prap.  
 Ura..., f. 275, par.  
 Dimri..., f. 137, prap.  
 Koha..., f. 320, prap.  
 Koha..., f. 306, prap.  
 Koha..., f. 323, 262; Gjakftoht..., f. 264, 19, prap.  
 Ura..., f. 470, prap.  
 Ura, ..., f. 255, komp.  
 Ura..., f. 250, 255, komp.  
 Ura ..., f. 153, komp.  
 Kronikë..., f. 45, komp.  
 Kronikë..., f. 26, komp.  
 Dimri..., f. 190, 433, prap.  
 Dimri..., f. 242, komp.  
 Dimri..., f. 416, nyjë+par.  
 Dimri..., f. 530, komp.  
 Dimri..., f. 551; Koha..., f. 298; Ura..., f. 309, konv.  
 Dimri..., f. 600; Ura..., f. 477, 284, komp.

Pasës, em.  
 Pragist, em.  
 I paradokshëm, mb.  
 Porsaislamizuar, em.  
 Protrojan, em.  
 Prangos, f.  
 Prangues, em.  
 Pagjum,-i, em.  
 I pavërejtshëm, mb.  
 Parajzor, mb.  
 Prillmort, em.  
 Parazbuloj, f.  
 Pangutësi, em.  
 Përsëdyten, f.  
 Përsëtreten, f.  
 Pikëllimtar, mb.  
 Përtejbotë, em.  
 Pushimtar, em.  
 I pazhvendosshëm, mb.  
 Plotshmëri, em.  
 Qartësim, em.  
 Qelqëri, em.  
 Qelqan, mb.  
 Qamilist, em.  
 Qimefob, em.  
 Qimeman, em.  
 Rebelshtypës, em.  
 Rënkueshëm, nd.  
 Rimorkiotozaur em.  
 Rënkimtar, em.  
 Rrugor, em.  
 I statujtë, mb.  
 Skënderbejadë, em.  
 Spicekip, em.  
 Supershtet, em.  
 Selemno-rozë - buzëqeshëse, mb.  
 Statujor, mb.  
 Sterrimë, em.  
 I stërkeq, mb.  
 Stërshtet, em.  
 I stërmoçëm, mb.  
 Stërmbret, em.  
 Dimri..., f. 578, prap.  
 Koha..., f.100, prap.  
 Koha..., f. 70, nyjë-prap.  
 Koha..., f. 86, komp.  
 Koha..., f. 109, par.  
 Koha..., f. 153, prap.  
 Koha..., f. 236, prap.  
 Koha..., f. 248,32, komp.  
 Koha..., f. 302, nyjë+prap.+par.  
 Koha..., f. 402, prap.  
 Gjakftoht..., f.495, komp.  
 Gjakftoht..., f. 495, komp.  
 Gjakftoht..., f. 102, komp.  
 Emblema, f. 171, komp.  
 Ura..., f. 498,400 komp.  
 Ura..., f. 498, prap.  
 Ura..., f.473, komp.  
 Ura ..., f. 359, prap.  
 Ura..., f. 317, par.  
 Ura..., f. 255, prap.  
 Ura...f. 77, prap.  
 Dimri..., f. 277, prap.  
 Dimri..., f. 87, prap.  
 Koha..., f. 327, prap.  
 Koha..., f. 236, prap.  
 Koha..., f. 236, prap.  
 Ura..., f. 227 komp.  
 Gjakftoht..., f. 254, prap.  
 Dimri..., f. 510, komp.  
 Koha..., f. 24, prap.  
 Ura..., f. 35, prap.  
 Ura..., f. 190, nyjë-prap.  
 Ura..., f. 245, prap.  
 Ura..., f. 249, komp.  
 Ura..., f.249, par.  
 Ura..., f. 409, komp.  
 Dimri..., f. 532, prap.  
 Dimri..., f.414, prap.  
 Dimri..., f. 281, par.  
 Koha..., f. 158; Ura..., f. 122, par.  
 Ura..., f. 358; Emblema..., f. 261, par.  
 Ura..., f. 348, par.

I stërlavdishëm, mb.  
 Stërqiell, em.  
 I stërmundimshëm, mb.  
 Stërvdekje, em.  
 I stërgjatë, mb.  
 I stërlargët, mb.  
 Stërlulërimë, em.  
 Stërkeqet, f.  
 Shkurtan, em.  
 Shurdhëri, em.  
  
 Shurdhan, mb.  
  
 Shpendnajë, em.  
 Shkujdesshëm, nd.  
 I shkretëtirtë, mb.  
 Shurdhtazi, nd.  
 I shkretueshëm, mb.  
 Shkëndijim, em.  
 Shqetësueshëm, nd.  
 Shkëndijues, mb.  
 Shkretimtar, mb.  
 Shtrigor, em.  
 Shkokë, em.  
 Shkokëzohet, f.  
 Tempullor, mb.  
 I truallzuar, mb.  
 Tallazitje, em.  
 Trallisës, mb.  
 Trembshëm, nd.  
 Truallsor, mb.  
 Tejjetshmëri, em.  
 Tëhuajzim, em.  
 I Trishtëm, mb.  
 Turpëri, em.  
 Tejvdekje, em.  
 Thashethemnohet, f.  
 Thashethemnajtë, em.  
 Thirravajshëm, nd.  
 Vajtimthi, nd.  
 Vdekëron, f.  
 Varshavist, em.  
  
 Ura..., f. 301, par.  
 Dimri..., f. 574, par.  
 Dimri..., f. 438, par.  
 Ura..., f. 71, par.  
 Ura..., f. 137, par.  
 Ura..., f. 507, par.  
 Dimri...,f. 353, par.  
 Dimri..., f. 350, par.  
 Dimri..., f. 142, prap.  
 Dimri...,f. 340; Gjakftoht...,f. 216,359; Ura...,  
 f. 417,390,98, prap.  
 Ura...,f. 417 Gjakftoht..., f.354; Koha...,  
 f.140; Emblema..., f. 174, prap.  
 Ura..., f. 301,280, prap.  
 Dimri..., f,573; Koha..., f. 336, par.+prap.  
 Dimri...,f. 180; Ura..., f.117, nyjë+prap.  
 Gjakftoht...,f. 311, prap.  
 Koha...,f. 256, nyjë+prap.  
 Koha..., f. 226, prap.  
 Koha..., f. 84, prap..  
 Ura..., f. 39, prap.  
 Ura..., f. 154, prap.  
 Ura..., f. 226, prap.  
 Ura..., f. 278,273, par.  
 Ura..., f. 348, par.  
 Ura..., f. 404, prap.  
 Ura..., f. 272, nyjë+ pjes.  
 Ura..., f. 134, prap.  
 Ura..., f. 135, prap.  
 Koha..., f. 324, prap.  
 Emblema..., f. 237, prap.  
 Gjakftoht..., f. 158, komp.  
 Gjakftoht..., f. 255, prap.  
 Gjakftoht..., f. 237, nyjë + prap.  
 Gjakftoht..., f. 231, prap.  
 Gjakftoht...,f. 158, komp.  
 Ura..., f. 92, prap.  
 Koha..., f. 173; Gjakftoht..., 94,156, prap.  
 Koha..., f. 361, prap.  
 Ura..., f. 278, prap.  
 Ura..., f. 71, prap.  
 Koha..., f. 100, prap.

Vetueshëm, nd.  
 Vajzërohet, f.  
 Vdekësor, mb.  
 Vetëmor, mb.  
 Vajtueshëm, nd.  
 vëmendshëm, nd.  
 vakëflënës, em.  
 vetçheroizoj, f.  
 Vetmoj, f.  
 I vetëvrari, em.  
 Vdektar, em.  
 Ylberor, mb.  
 Yllëzim, em.  
 Yllnajë, em.  
 Yllësim, em.  
 Zymtor, mb.  
  
 Zymtan, mb.  
 Zymtësisht, nd.  
 Zymtar, mb.  
 Zerokrejt, em.  
 Zbehtësisht, nd.  
 Zhurmëri, em.  
 Zhabllimë, em.  
 Zhbërje, em.  
 I zhdukshëm, mb.  
 Zhvendos, f.  
 Zhbëhet, f.  
  
 Gjakftoht..., f. 299, prap.  
 Ura ..., f. 71, prap.  
 Ura..., f. 21; Kronikë..., f. 186, prap.  
 Dimri..., f. 288, prap.  
 Dimri..., f. 420, konv.  
 Koha..., f. 384, konv.  
 Gjakftoht..., f. 91, komp. .  
 Dimri...,f. 167, komp.  
 Dimri..., f. 191, prap.  
 Dimri..., f. 429, komp.  
 Dimri..., f. 345, prap.  
 Koha..., f. 370, prap.  
 Gjakftoht..., f. 255, prap.  
 Ura..., f. 297, prap.  
 Ura..., f. 285, prap.  
 Ura ..., f. 70; Emblema..., f. 202; Gjakftoht...,  
 f. 305, prap.  
 Koha ..., f. 135, prap.  
 Ura..., f. 60, prap  
 Ura....f. 19, prap.  
 Ura..., f. 256, komp.  
 Dimri..., f. 123, prap.  
 Ura..., f. 396,137, prap.  
 Dimri..., f. 88, prap.  
 Gjakftoht..., f.213, prap.  
 Emblema..., f. 179, par.  
 Ura..., f. 273, par.  
 Ura..., f. 348, par.<sup>27</sup>

27 Disa nga njësitë e përfshira në këtë listë të jenë përdorur dhe më parë ose janë shtrirë në përdorim e nuk ndihen më si neologjizma /vajtueshëm,monotonisht etj. Por asnjëra nga leksemat e renditura më lart nuk përfshihet në FGJSH (1980).



## Letërsi e shqyrtuar

1. Kronikë në gur, Tiranë, 1978
2. Gjenerali i ushtrisë së vdekur, Tiranë, 1980
3. Emblema e dikurshme, Tiranë, 1981
4. Ura me tri harqe, Tiranë, 1978
5. Koha e shkrimeve, Tiranë, 1986
6. Gjakftohtësia, Tiranë, 1980
7. Dimri i madh, Tiranë, 1980
8. Kështjella, Tiranë, 1973

## Letërsi teorike e konsultuar

1. A. Xhuvani – E.Çabej: *Prapashtesat e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1962
2. A. Xhuvani: *Origjina dhe formimi i ndajfoljeve në shqip*, Buletini i Institutit të shkencës, III, 2, 1949
3. A. Kostallari, *Mbi disa veçori të fjalës së përbërë në gjuhën shqipe*, Studime mbi leksikun dhe formimin e fjalëve në gjuhën shqipe, 1, 1972
4. A. Kostallari: *Kompozitat ekzocentrike të shqipes si tema fjalëformuese*, Studime mbi leksikun dhe formimin e fjalëve në gjuhën shqipe, 1, 1972
5. A. Kostallari: *Në rrugën e hartimit të fjalorit normativ të shqipes së sotme*, Studime mbi leksikun dhe formimin e fjalëve në gjuhën shqipe, 2, 1972
6. A. Kostallari: *Kompozitat dëshirore të shqipes*, SF, 1968, 4
7. A. Kostallari – Xh. Lloshi: *Mbi gjuhën e shtypit të sotëm*, “Norma letrare kombëtare dhe kultura e gjuhës”, I, 1993
8. A. Kostallari: *Fjalori i gjuhës së sotme shqipe*, “Nëntori”, 1985
9. A. Dhrimo: *Fan Stilian Noli – tribun i fjalës shqipe*, Gjuha jonë, 2, 1987
10. A. Vehbiu: *Gjuhët e huaja, neologjizmat dhe ligjërimi*, Gjuha jonë, 1, 1986
11. E. Lafe: *Përsëritja si mjet gramatikor*, SF, 4, 1966
12. T. Angoni: *Pjesëzat në gjuhën shqipe*, SF, 3, 1971
13. G. Beja: *Kalimi i stilemeve nga gjuhët e huaja në gjuhën shqipe dhe anasjelltas*, Gjuha jonë, 1, 1986
14. G. Hadaj: *Shembuj analize teksti*, “Revista Pedagogjike”, 3, 1984
15. J. Thomai: *Krijimtaria gjuhësore e shkrimtarit, shprehje e prirjeve të tij ideore e stilistike*, “Drita”, 25. 01. 1981
16. J. Thomai: *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1984, 1999
17. J. Kole: *Pjesëzat si kategori leksiko-semantike në shqipen e sotme*, SF, 3, 1969
18. K. Cipo: *Gramatika shqipe*, Elbasan, 2014
19. L. Buxheli: *Emrat e veprimtimit me prapashtesën -im dhe -je në gjuhën letrare shqipe*, SF, 4, 1981

20. M. Ymeri: *Vëzhgime për gjuhën e prozës artistike*, Gjuha jonë, 2, 1982
21. Sh. Demiraj: *Gjuha e Sami Frashërit*, BSHSH, 3, 1955
22. Xh. Lloshi: *Njohuri për stilistikën e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1987
23. Xh. Lloshi: *Shkrimtari dhe gjuha*, "Norma letrare kombëtare dhe kultura e gjuhës", 1, 1973
24. Fjalor shpjegues i termave të letërsisë, Tiranë 1972
25. Fjalor i Gjuhës së Sotme Shqipe, 1980, 1984
26. Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe, II, III, Tiranë, 1976, 1983
27. Gramatika e gjuhës shqipe, I, Tiranë, 2002
28. Baylon-Fabre: *Grammaire systematique de la langue française*, Paris, 1978
29. Benveniste: *Problemes de linguistique generale*, Paris, 1966
30. Blumfeld: *Jazik*, Moskë, 1966
31. Guirand: *La stylistique*, Paris, 1954
32. Jokli: *Naim be Frashëri dhe pasurimi i gjuhës shqipe*, 1925
33. Jakobson: *Essais de linguistique generale*, Paris, 1963. **Etj.**